



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 12.10.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimi “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për Kancelar, për Këshilltar ose për Ndihmës Ligjor”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Marçela Shehu</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Alban Toro**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 5. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 6. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 7. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 8. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe Projekti i USAID.**

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimi “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për Kancelar, për Këshilltar ose për Ndhmës Ligjor”.

**Naureda Llagami:** Atëherë, përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 12 tetor 2020.

Të pranishëm janë të gjithë anëtarët e Këshillit, përveç Zotit Toro, i cili për arsye shëndetësore e ka të pamundur të jetë sot në mbledhjen e sotshme.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës sot janë 4 çështje për të cilat kërkohet një vendimmarrje nga ana e KLGJ-së dhe bëhet fjalë konkretisht: Shqyrtimi i projektvendimit “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për Kancelar, për Këshilltar ose për Ndhmës Ligjor”; Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve në investime për realizimin e

sistemit elektronik te Organizatave Jofitimprurëse, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”; Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi propozimin për llojet dhe masat e tarifave gjyqësore dhe procedurën e mbledhjes së tyre”; Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Jeni dakord me rendin e ditës?

*(Anëtarët e Këshillit janë dakord me rendin e ditës.)*

Atëherë, pa humbur kohë kalojmë në çështjen e parë, e cila kuptohet është një nga vendimet e rëndësishme që Këshilli i Lartë Gjyqësor do të miratojë sot.

Për më shumë detaje, unë do ftoja zotin Toska për një relativitet të projektvendimit.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për Kancelar, për Këshilltar ose për Ndhmës Ligjor”. Drafti i këtij projektvendimi është dërguar më herët, sikundër edhe relacioni në lidhje me të.

Në mënyrë të përmbledhur lidhur me këtë projektvendim, mund t’ju them se Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësisë për drejtimin dhe kujdesin për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “d”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 53, 55 dhe 83, të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 165, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 6 të Ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, duke qenë përgjegjës për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor dhe për ndihmës ligjor, ka filluar procesin për miratimin e rregullave më të detajuara, të cilat do të përcaktojnë rregulla për procedurën që zbaton Këshilli i Lartë Gjyqësor për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor ose për ndihmës ligjor.

Vlen të përmendet se ky projektvendim ka qenë për shqyrtim në mbledhjen plenare të datës 23.01.2020. Në këtë rast, Këshilli vendosi që projektvendimi të rishikohej, duke konsideruar që verifikim të pasurisë dhe figurës të kishte vetëm për kandidatët fitues për në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës rishikoi në tërësi projektvendimin, duke e strukturuar atë ndryshe, por edhe përmirësuar e plotësuar më tej.

Duhet nënvizuar fakti se projektvendimi është përgatitur edhe me kontributin e misioneve që asistojnë Këshillin, konkretisht projekteve EURALIUS dhe “Drejtësi për të gjithë”.

Projektvendimi “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, që ju është paraqitur për miratim, i hap rrugë verifikimit të kancelarit, këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë dhe ndihmësit ligjor në gjykatat e apelit, përfshirë edhe ata në detyrë, ata që kanë përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020 apo edhe ata që janë pranuar në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

Lidhur me përmbajtjen e projektvendimit, ai është i strukturuar në 12 (dymbëdhjetë) krerë, të cilët në mënyrë të përmbledhur përmbajnë rregullime si vijon:

Në Kreun I të projektvendimit, titulluar “Qëllimi, objekti dhe subjektet”, përcaktohet qëllimi i projektvendimit, që është përcaktimi i rregullave më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, si dhe të pasurisë dhe të figurës së tij, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të parimeve të përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, transparencës, informimit, drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, mbrojtjes së të dhënave, konfidencialitetit e të sekretit shtetëror dhe të proporcionalitetit, për zbatimin e unifikuar të standardeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Subjekte të këtij vendimi janë: i) kandidati për në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit; ii) kandidati fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit; iii) kandidati për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit; iv) kancelari në detyrë, këshilltari ligjor në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe ndihmësi ligjor në detyrë në gjykatat administrative. Të gjithë subjektet verifikohen për kushtet dhe kriteret ligjore, ndërsa subjektet sipas pikës “ii” dhe “iv” verifikohen edhe për pasurinë dhe figurën.

Në Kreun II të projektvendimit, titulluar “Kudri ligjor”, janë listuar aktet ligjore sipas të cilëve do të interpretohet dhe zbatohet projektvendimi.

Ndërsa në Kreun III të projektvendimit, titulluar “Përkufizimet”, jepen përkufizimet që do të kenë termat e përdorura në projektvendim.

Në Kreun IV të projektvendimit, titulluar “Rregulla të përgjithshme për verifikimin e kandidatëve”, përcaktohen rregullat e përgjithshme për verifikimin e kandidatëve. Ky Kre ndahet në 7 seksione (A, B, C, Ç, D, DH dhe E).

Seksioni A i këtij Kreu, titulluar “Objekti i verifikimit sipas kategorisë së kandidatëve”, përcakton objektin e verifikimit për secilin kategori kandidatësh.

Seksioni B i këtij Kreu, titulluar “Fazat e procedurës së verifikimit”, përcakton fazat nëpër të cilat kalon procedura e verifikimit, e cila sipas rastit kalon në tre faza (në rastin e procedurave për subjektet që realizohen nga Komisioni i Përkohshëm) ose në katër faza (në rastin e procedurave për subjektet që realizohen nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit).

Seksioni C i këtij Kreu, titulluar “Organet e verifikimit”, përcakton se cilët janë organet që realizojnë procedurën e verifikimit. Ky Seksion ndahet në tre nënseksione (C.1, C.2 dhe C.3).

Nëseksioni C.1 titulluar “Relatori” përcakton mënyrën se si caktohet relatori në procedurën e verifikimit, si dhe cilat janë veprimet verifikuese dhe procedurale që ai kryen në kuadër të kësaj procedure.

Nëseksioni C.2 titulluar “Komisioni” përcakton Komisionin e Përkohshëm ose Komisionin e Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit si pjesë të procedurës së verifikimit dhe mënyrën se si ai mblidhet dhe çfarë shqyrton, si dhe mënyrën se si merret vendimmarrja.

Nëseksioni C.3 titulluar “Këshilli” rregullon mënyrën se si mblidhet Këshilli, sesi vijon shqyrtimi i çështjes dhe mënyra sesi votohet.

Seksioni Ç i këtij Kreu, titulluar “Të drejtat e kandidatit”, përcakton se cilat janë të drejtat e kandidatit gjatë procedurës së verifikimit.

Në Seksionin D të këtij kreu, titulluar “Afatet dhe llogaritja e tyre”, përcaktohen rregullat në lidhje me afatet në procedurat e verifikimit të kandidatëve.

Në Seksionin DH të këtij Kreu, titulluar “Njoftimet”, jepen rregullat në lidhje me njoftimet gjatë zhvillimit të procedurës.

Ndërsa në Seksionin E të këtij Kreu, rregullohet “Dorëheqja dhe përjashtimi për shkak të konfliktit të interesit”.

Kreu V i projektvendimit, titulluar “Procedura e verifikimit të kandidatëve për në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës” përcakton se cilët janë kushtet/kriteret e përgjithshme të pranimit në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, të cilat përcaktohen në nenin 55, pika 1 e Ligjit për Pushtetin gjyqësor si dhe në nenin 21 të Ligjit “Për nëpunësin civil”. Kriteret e veçanta të pranimit në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar për kancelar në Shkollën e Magjistraturës, përcaktohen në pikën 1, të nenit 56 të Ligjit për Pushtetin gjyqësor. Kriteret e veçanta të pranimit në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, në Shkollën e Magjistraturës, përcaktohen në pikën 2, të nenit 56 të Ligjit për Pushtetin gjyqësor. Kriteret e veçanta të pranimit në provimin e pranimit në programin e

formimit fillestar për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, parashikohen në pikën 3, të nenit 56 dhe pikën 6, të nenit 34 të Ligjit për Pushtetin gjyqësor. Në vijim, të këtij Kreu rregullohet mënyra se si fillon procedura e verifikimit, mënyrën se si njoftohen kandidatët, si dhe mënyrën se si procedon Komisioni i Përkohshëm, në përfundim të procedurës së verifikimit si dhe kur Komisioni ka përgatitur çështjen.

Kreu VI i projektvendimit, titulluar “Procedura e verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës” ndahet në 4 Seksione ( A, B, C dhe Ç).

Seksioni A i këtij Kreu, titulluar “Rregulla të përgjithshme” përcakton se kandidati fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, i nënshtrohet verifikimit të pasurisë dhe figurës. Më tej parashikohen rregulla se si fillon procedura e verifikimit, zgjedhja e relatorit nga anëtarët e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, si dhe njoftimi i kandidatit dhe të drejtat dhe detyrimet që ai ka në këtë fazë të procedurës.

Seksioni B i këtij Kreu, titulluar “Verifikimi i pasurisë” rregullon mënyrën se si zhvillohet procedura e verifikimit të kriterit të pasurisë. Jo më vonë se 3 ditë, nga ajo e njoftimit të procedurës, kandidatit i dërgohen Formulari “Deklaratë e Pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”, si dhe informacion mbi lidhjen elektronike të ILDKPKI-së. Kandidatit, i dërgohen në të njëjtën kohë edhe formularët autorizues për Këshillin, që i jep të drejtë këtij të fundit për të kryer verifikime dhe për të kërkuar raportim, nga çdo subjekt publik dhe privat në kuadër të verifikimit të kriterit të pasurisë. Më pas, Këshilli, i dërgon ILDKPKI-së listën e kandidatëve, duke i kërkuar që në rast mosdorëzimi të deklaratës brenda afatit të njoftojnë Këshillin. Gjithashtu, relatori fillon procedurat për kryerjen e veprimeve të kërkimit, në organet e administratës doganore dhe tatimore. Më tej rregullohen veprimet e mëtejshme verifikuese që kryhen në kuadër të këtij verifikimi. Në këtë seksion parashikohet edhe e drejta e relatorit, që të thërrasë ekspertë të fushës përkatëse, në rast se kërkohen njohuri të posaçme lidhur me konstatimin dhe sqarimin e

të dhënave që rezultojnë nga shpjegimet e kandidatit, gjetjet dhe përfundimet e ILDKPKI-së dhe atyre të sjella nga organet e administratës tatimore dhe doganore.

Seksioni C i këtij Kreu, titulluar “Verifikimi i figurës” rregullon mënyrën sesi zhvillohet procedura e verifikimit të kriterit të figurës. Kandidatit, jo më vonë se 3 ditë, nga ajo e njoftimit për fillimin e procedurës së verifikimit, i dërgohen në rrugë elektronike formulari i vetëdeklarimit sipas Ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, informacion mbi lidhjen elektronike në faqen zyrtare të Këshillit, për formularin e sipërcituar dhe formulari autorizues për Këshillin, që i jep të drejtë të kryejë verifikime dhe të kërkojë raportim, informacion dhe dokumentacion nga organet kompetente për verifikimin e figurës. Më tej, përcaktohen veprimet që kryen relatori në kuadër të procedurës për verifikimin e kriterit të figurës.

Seksioni Ç i këtij Kreu, titulluar “Përfundimi i verifikimit” rregullon mënyrën se si vendos Këshilli në përfundim të procedurës së verifikimit. Në rast se kandidati kualifikohet ai lejohet të vijojë ndjekjen e programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë ose ndihmës ligjor në gjykatat e apelit. Gjithashtu, në këtë Seksion përcaktohen në mënyrë të qartë të gjitha rastet se kur vendoset nga ana e Këshillit skualifikimi i kandidatit, sa i përket kriterit të pasurisë dhe të figurës.

Kreu VII i projektvendimit, titulluar “Procedura e verifikimit të kandidatëve për në shërbimin civil gjyqësor” rregullon procedurën e verifikimit për kandidatin për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë, ose për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, që përfundon programin respektiv të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Këta kandidatë i nënshtrohen verifikimit të kushtit formal të pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

Kandidatët pranohen në shërbimin civil nëse plotësojnë kushtin e kalimit me sukses të programit përkatës të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, sipas përcaktimit të pikës 7, të nenit 53, të Ligjit për Pushtetin gjyqësor.



Jo më vonë se dy javë nga dërgimi prej Shkollës së Magjistraturës, së listës së kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar, mbi propozim të relatorit të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli vendos në lidhje me kualifikimin dhe vijimin e procedurës së emërimit të kandidatëve që kanë përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për secilën kategori. Vendimi i Këshillit mbështetet në listën e kandidatëve si dhe rezultatet e tyre në provimin përfundimtar. Skualifikimi i kandidatit dhe refuzimi për emërimin e tij vendoset në ato raste kur ai ka marr më pak se 70 për qind të pikëve totale në provimin përfundimtar të programit të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

Kreu VIII i projektvendimit, titulluar “Procedura e verifikimit të kandidatëve për në shërbimet e Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” përcakton rregulla të veçanta për verifikimin e kandidatëve për në shërbimet e gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar për shkak të përcaktimeve edhe në Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Kandidati për kancelar në këto gjykata të posaçme ose ndihmësi ligjor në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar pranohet në shërbimet e këtyre gjykatave, nëse plotëson kushtin e pranimit në shërbimin civil gjyqësor, si dhe kushtet shtesë të sigurisë të përcaktuar në Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Kandidati i nënshtrohet sërish verifikimit të pasurisë dhe figurës.

Më tej, në këtë Kre rregullohet mënyra e fillimit të procedurës së verifikimit, zgjedhja e relatorit, aktet që i njoftohen kandidatit, afatet brenda të cilave dërgohen aktet dhe duhet të paraqiten të plotësuara. Duhet theksuar se verifikimin e kandidatëve për në shërbimet e gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar e bën Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, në bazë të përcaktimeve në Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Ky Komision përpilon një raport për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatit, mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe mbi

pastërtinë e figurës së kandidatit. Relatori shqyrton rezultatet e kontrollit, gjetjet dhe përfundimet e raportit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve. Në varësi të rezultateve dhe nevojave që paraqiten, relatori mund të kërkojë: a) raport shtesë nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve; b) shpjegime me shkrim nga kandidati.

Kur kandidati paraqet shpjegime dhe dokumente mbështetës që kundërshtojnë rezultatet e raportit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, ato i dërgohen këtij të fundit, duke i kërkuar trajtimin e tyre dhe bërja e një raporti shtesë.

Në përfundim të procedurës së verifikimit, në varësi të rezultateve, Këshilli vendos në lidhje me kualifikimin e kandidatit dhe vijimin e procedurës së mëtejshme për emërimin, transferimin ose ngritjen në detyrë si kancelar në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, ose si ndihmës ligjor në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ndërsa, skualifikimi i kandidatit dhe refuzimi për emërim, transferim ose ngritje në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, vendoset nga Këshilli kur kandidati nuk plotëson kushtet e pranimit në shërbimin civil gjyqësor, kushtet shtesë të sigurisë të përcaktuara në Ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si dhe nuk kalon verifikimin e pasurisë si dhe atë të figurës për rastet e përcaktuara në mënyrë të detajuar në përmbajtje të projektvendimit.

Kreu IX i projektvendimit, titulluar “Vendimi i verifikimit dhe e drejta e ankimit” përcakton rregulla mbi vendimin e Këshillit, se si duhet arsyetuar, faktin që i njoftohet kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, i shoqëruar me arsyetimin përkatës. Ndaj vendimit të Këshillit, për skualifikimin e kandidatit, parashikohet e drejta e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Në rast se gjykata pranon ankimin e kandidatit, atëherë Këshilli, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit, rishikon vendimin e tij në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës. Vendimi i Këshillit

për përfundimin e procedurës së kandidimit për kandidatin që tërhiqet nga kandidimi, është i paankimueshëm.

Kreu X i projektvendimit, titulluar “Publikimi i vendimeve të verifikimit” përcakton se vendimet i Këshillit për verifikimin e kandidaturave bëhen publike në faqen zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të Këshillit publikohet edhe lista e kandidatëve të kualifikuar si dhe ajo e kandidatëve të skualifikuar.

Kreu XI i projektvendimit, titulluar “Dispozita për kancelarët, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë në detyrë” përcakton rregulla të detajuara për kancelarët, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë në detyrë dhe ka marrë një vëmendje të rëndësishme në këtë Projektvendim. Ky Kre ndahet në tre Seksione (A, B dhe C).

Seksioni A i këtij Kreu, titulluar “Verifikimi, emërimi në shërbimin civil gjyqësor ose ndërprerja e marrëdhënieve të punës, për kancelarët në detyrë”, përcakton rregulla në lidhje me procedurën e verifikimit për kancelarët në detyrë, emërimin e tyre në shërbimin civil ose ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Kancelari në detyrë i nënshtrohet verifikimit: a) të kushteve dhe kriterëve formale të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, konkretisht: kushteve/kriterëve të përgjithshme sipas nenit 55, pika 1, të Ligjit për Pushtetin gjyqësor në lidhje me nenin 21 të Ligjit “Për nëpunësin civil”, si dhe të kriterëve të veçanta sipas nenit 56, pika 1, të Ligjit për Pushtetin gjyqësor; b) të pasurisë dhe figurës. Për kancelarin në detyrë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, verifikimi i pasurisë dhe figurës kryhet nga Komisioni i Posaçëm i ngritur sipas Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve formale, të pasurisë dhe figurës, për kancelarët në detyrë, fillon jo më vonë se 7 ditë nga hyrja në fuqi e këtij projektvendimi. Më tej rregullohet vendimmarrja e Këshillit. Në këtë rast, Këshilli vendos për kualifikimin dhe lejimin e kancelarit në detyrë për të marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës për vlerësimin profesional të tij ose për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në funksionin e kancelarit.

Kur kancelari në detyrë kualifikohet dhe pas vlerësimit profesional nga Shkolla e Magjistraturës, arrin të marrë në provim të paktën 70 për qind të pikëve totale, emërohet nga Këshilli në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin që ai mban, brenda një jave nga dërgimi prej Shkollës së Magjistraturës të rezultateve të provimit.

Kur kancelari në detyrë kualifikohet dhe nuk arrin të marrë në provim të paktën 70 për qind të pikëve totale, i ndërpriten marrëdhëniet e punës në funksionin e kancelarit brenda një jave nga dërgimi prej Shkollës së Magjistraturës të rezultateve të provimit. Në këtë rast, mbi kërkesën e tij, Këshilli vlerëson mundësitë ekzistuese për sistemimin në një pozicion tjetër në administratën e gjykatës, të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale. Kundër vendimit të Këshillit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në funksionin e kancelarit, parashikohet e drejta e ankimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Seksioni B i këtij Kreu, titulluar “Verifikimi dhe emërimi në shërbimin civil gjyqësor, për këshilltarët ligjorë në detyrë në Gjykatën e Lartë” përcakton rregulla në lidhje me verifikimin dhe emërimin në shërbimin civil gjyqësor, për këshilltarët ligjorë në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Këshilltari ligjor në detyrë në Gjykatën e Lartë është subjekt rivlerësimi kalimtar sipas përcaktimeve kushtetuese dhe atyre ligjore. Konfirmimi i tij në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar sipas këtij ligji, përbën kusht për pranimin në shërbimin civil gjyqësor. Këshilli, jo më vonë se 7 ditë nga depozitimi pranë tij të vendimit përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar për konfirmimin në detyrë të këshilltarit ligjor në detyrë në Gjykatën e Lartë, mbi propozimin e relatorit të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, e emëron atë në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin e këshilltarit ligjor pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Lartë, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Pushtetin gjyqësor dhe nenin 165, pika 9, të Ligjit për Statusin.

Seksioni C i këtij Kreu, titulluar “Verifikimi, emërimi në shërbimin civil gjyqësor ose ndërprerja e marrëdhënieve të punës, për ndihmësit ligjorë në detyrë në gjykatat administrative” përcakton rregulla për verifikimin, emërimin në shërbimin civil gjyqësor

ose ndërprerja e marrëdhënieve të punës, për ndihmësit ligjorë në detyrë në gjykatat administrative. Ndhimësi ligjor në detyrë në gjykatat administrative është subjekt rivlerësimi kalimtar. Konfirmimi i tij në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit 84/2016, përbën kusht për pranimin në shërbimin civil gjyqësor.

Ndhimësit ligjorë në detyrë në gjykatat administrative, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit kalimtar, vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të Ligjit për Pushtetin gjyqësor dhe Ligjit për Statusin e gjyqtarëve, e më konkretisht: a) ndihmësit ligjorë në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në të njëjtën detyrë; b) ndihmësit ligjorë në detyrë në gjykatat administrative të shkallës së parë emërohen përkohësisht në gjykatat e apelit, si rregull, në gjykatat e apelit që mbulojnë të njëjtin juridiksionin tokësor. Emërimi i përkohshëm bëhet nga Këshilli, jo më vonë se shtatë ditë nga krijimi i njësisë të shërbimit ligjor në gjykatat e apelit, mbi propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, duke ruajtur një shpërndarje të drejtë të ndihmësve ligjorë në varësi të nevojave të gjykatave dhe numrit të pozicioneve të lira në ato.

Ndhimësi ligjor që konfirmohet në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 165, pika 9, të Ligjit për Statusin ka të drejtën e caktimit në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit të tij aktual dhe për të cilin përmbush kriteret. Në këtë Seksion rregullohet edhe se çfarë ndodh kur kërkesa paraqitet në afat dhe kur nuk paraqitet kërkesë në afat. Kërkesa për t'u caktuar në pozicion shqyrtohet nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Nëse ajo konsiston në caktimin në një pozicion nëpunësi civil gjyqësor në kompetencë të Këshillit, mbahet për shqyrtim. Në rast të kundërt, kërkesa i dërgohet menjëherë për shqyrtim këshillit të gjykatës përkatëse.

Për shqyrtimin e kërkesës në kompetencë të Këshillit, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit cakton, me short, një anëtar të saj.

Më tej në këtë Seksion rregullohet mënyra se si procedon Këshilli në rast të pranimit të kërkesës të subjektit në shërbimin civil gjyqësor dhe caktimin e tij në pozicionin e kërkuar ose refuzimin e kërkesës për caktimin në pozicion dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të përkohshme të punës në funksionin e ndihmësit ligjor.

Në rast se përpara Këshillit, në të njëjtën kohë, janë për shqyrtim disa kërkesa për caktimin në të njëjtin pozicion të të njëjtës gjykatë, nga kategoria e ndihmësve ligjorë të konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, ato shqyrtohen nga i njëjti relator. Caktimi në pozicion në këtë rast bëhet mbi bazë konkurrimi. Këshilli zgjedh kandidatin, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme sipas kësaj radhe: a) renditjen e tyre në testin e aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, të zhvilluar sipas parashikimeve të Ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; b) çdo njohuri ose përvojë të veçantë të kandidatit, që e bën atë veçanërisht të kualifikuar për vendin e lirë; c) vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose në pozicione drejtuese.

Kandidati që i refuzohet kërkesa për caktim në pozicion dhe i ndërpriten marrëdhëniet e punës, apo kandidati që nuk përzgjidhet për shkak të konkurrimit, në të njëjtën kohë, me të tjerë, për të njëjtin pozicion, kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Nëse ndihmësi ligjor i konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, caktohet sërish, sipas këtij Seksioni, në pozicionin e ndihmësit ligjor, atëherë ky vendim konsiderohet si vendim konfirmimi në kuptim të nenit 62, pika 3, shkronja “a”, të Ligjit për Pushtetin gjyqësor.

Nëse ndihmësi ligjor në detyrë i konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, caktohet sipas këtij Seksioni, në një pozicion nëpunësi civil gjyqësor të ndryshëm nga ai i ndihmësit ligjor, atëherë ky vendim konsiderohet si vendim emërimi paraprak në kuptim të nenit 61, të Ligjit për Pushtetin gjyqësor.

Ndihmësi ligjor në detyrë, të cilit i është refuzuar kërkesa për caktim në pozicion për mosplotësim të kriterëve të veçanta sipas nenit 56 të Ligjit për Pushtetin gjyqësor

mund të kërkojë sistemimin në një pozicion tjetër në administratën e gjykatës. Në këtë rast, Këshilli vlerëson mundësitë ekzistuese për sistemimin në një pozicion tjetër në administratën e gjykatës, të përshtatshëm dhe në përputhje me kriteret ligjore dhe profesionale.

Kreu XII i projektvendimit, titulluar “Dispozita kalimtare dhe të fundit” ndahet në katër seksione (A, B, C dhe Ç).

Seksioni A i këtij Kreu, titulluar “Verifikimi dhe emërimi në shërbimin civil gjyqësor, për kandidatët për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë, që kanë përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020”, rregullon mënyrën se si do të bëhet verifikimi dhe emërimi në shërbimin civil gjyqësor, për kandidatët për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë, që kanë përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020.

Seksioni B i këtij Kreu, titulluar “Verifikimi dhe emërimi në shërbimin civil gjyqësor, për kandidatët për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit, që kanë përfunduar programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020”, rregullon mënyrën se si do të bëhet verifikimi dhe emërimi në shërbimin civil gjyqësor, për kandidatët për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit, që përfundojnë programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020.

Seksioni C i këtij Kreu, titulluar “Verifikimi i kandidatëve për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit, të pranuar në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021”, rregullon mënyrën se si do të bëhet verifikimi për kandidatët për këshilltarë ligjorë në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit, të pranuar në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

Seksioni Ç i këtij Kreu, titulluar “Dispozitë e fundit”, parashikon se projektvendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Faleminderit!

*Naureda Llagami*: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim mbi projektvendimin para se ta kalojmë për votim?

Nëse jo, e hedhim në votim.

**Brikena Ukperaj:** Kryetare, kam një diskutim.

**Naureda Llagami:** Po! –zonja Ukperaj, fjala për ju.

Vetëm të lutem, ngrije pak zërin sepse nuk dëgjohet.

**Brikena Ukperaj:** Përshëndetje!

Lidhur me përmbajtjen e këtij projektvendimi, në fakt, siç e përmendi relatori, ky vjen si një draft i ripunuar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, mbi disa dakordësime që ne patëm në mbledhjen e mëparshme plenare. Ajo që unë dua të theksoj është fakti që procedura e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët kancelarë, këshilltarë ligjorë apo ndihmës ligjorë në gjykatat e apelit nuk gjen parashikim shprehimisht në ligj, jo vetëm si procedurë e shprehur por edhe si një kusht rekrutimi i tyre në kategoritë e sipërcituara.

Megjithatë, Këshilli vendosi që në frymën e ligjit, në interpretim të nenit 53, pika 9, edhe për këta kandidatë, për të ruajtur parimin e trajtimit të barabartë të atyre që janë në atë pozicion dhe atyre që do të rekrutohen në këto pozicione, të kryhet verifikimi i pasurisë dhe figurës. Kjo gjë shkon edhe në interpretim të zgjeruar të dispozitave të ligjit “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive”, konkretisht neni 3, pika 1/c, i cili pranon që kandidatët për pranim në formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, janë subjekte që mund të verifikohen nga ILDKPKI-ja dhe duke pranuar që programi fillestar nuk janë vetëm kandidatët për magjistrët, përfshin edhe kandidatët për kancelarë, këshilltarë ligjorë dhe ndihmës ligjorë të gjykatave të apeleve, shkohet në interpretimin që edhe për këta kandidatë të bëhet verifikimi i pasurisë dhe figurës.

Ajo që unë doja të citoja është që gjithsesi, për të pasur një parashikim të qartë të kësaj procedure, në nismën për ndryshime ligjvënëse, ne duhet ta parashikojmë dhe ta referojmë këtë fakt, që mos të mbetet në kuadrin e një interpretimi që i bën Këshilli kësaj



situatë, por të jetë e parashikuar, të parashikohet edhe për subjektet e tjera që verifikimi i pasurisë dhe figurës është kusht për kualifikim edhe për emërimin në shërbimin gjyqësor civil. Ky ishte propozimi i parë.

Ndërsa, diskutimi i dytë që kam në lidhje me projektregulloren, është ajo për sa i përket Kreut të VII (nëse mund ta quajmë), që lidhet me procedurën e verifikimit të kandidatëve për në shërbimin civil gjyqësor.

Çfarë ndodh? – Gjithë rregullorja rregullon disa procedura që fillojnë me procedurat që ndjek Komisioni i Përkohshëm për lejimin e kandidatëve për t'u futur në provim në Shkollën e Magjistraturës (flas gjithmonë për kandelarët, për ndihmësit ligjorë dhe për këshilltarët ligjorë); ndjek më pas procedurën që kryen Këshilli për kandidatët që kanë fituar provimin, por do të lejohen për t'u futur në programin e formimit fillestar dhe në këtë moment Këshilli kryen verifikimin e pasurisë dhe figurës; dhe më tej rregullohet edhe një procedurë e tretë mbasi Shkolla e Magjistraturës i përcjell Këshillit listën me kandidatët që janë fitues.

Referuar ligjit, në fakt, pas ardhjes së listës nuk parashikohet ndonjë procedurë e posaçme që Këshilli duhet të caktojë prapë një relator, që këta t'i kualifikojë dhe më pas t'i lejojë për emërim, por kjo listë, sipas ligjit, qëndron në Këshillin e Lartë Gjyqësor 4 vjet dhe shfrytëzohet nga Këshilli sa herë që ka vende vakante dhe që duhet të zhvillojë një procedurë emërimi në këto pozicione.

Në vlerësimin tim, pika 93, 94, 95, 96 dhe 97 nuk është e nevojshme që të parashikohen në rregullore sepse thjesht mbingarkojmë Këshillin me një procedurë që mbetet formale. Lista e kandidatëve fitues nga Shkolla e Magjistraturës ne na vjen dhe aty duket se kush ka marrë 70% të pikëve dhe kush nuk ka marrë. Nuk është e nevojshme që të marrim një vendim skualifikimi për kandidatin që nuk ka marrë 70% të pikëve. Këtë listë ne e shfrytëzojmë sa herë ka emërim në shërbimin gjyqësor civil. Siç është shkruar në rregullore, duhet që dy javë mbasi shkolla na sjellë listën, të caktojë prapë relatorë dhe të merret relatori me secilin kandidat nga lista, të verifikojë nëse ky ka marrë 70% ose jo të pikëve, sepse kushti i vendosur formal i pranimit është thjesht vetëm marrja e pikëve dhe pastaj të marrë një vendim kualifikimi dhe lejimi për emërim, të cilin ndoshta

për 4 vjet mundet të mos e shfrytëzojmë asnjëherë. Prandaj për ta bërë më elastike procedurën dhe më efektive, unë do të propozoja që këto pika të mos parashikoheshin fare në rregullore, por të parashikohet që mbi listën që vjen nga shkolla Këshilli vazhdon procedurat e emërimit për shërbimin gjyqësor civil. Nuk e di nëse ka pasur ndonjë situatë tjetër Komisioni që i ka vlerësuar që duhet ta rrëgullojë pikërisht me këto dispozita. Iliri ndoshta edhe mund ta sqarojë.

**Ilir Toska:** Mund të sqaroj nëse vendoset skualifikimi i kandidatit do duhet një vendim formal sepse ka të drejtën e ankimit parimisht. Kështu që nuk mund të themi që erdhi lista nga shkolla dhe lista do qëndrojë në Këshill. Kur Këshilli të ketë nevojë, do ta shqyrtojë listën. Pra në pikëpamje formale do duhet një vendimmarrje e Këshillit, qoftë për ata që Këshilli i konsideron të kualifikuar dhe do të qëndrojë lista e pranueshme për 4 vjet, do duhet një akt formal i Këshillit. Prandaj kemi parashikuar një procedurë të thjeshtë, ku një nga anëtarët e Komisionit do të përcjellë në Këshill, qoftë listën, qoftë edhe projekt-propozimin që kandidati i plotëson kushtet apo kandidati që nuk i plotëson kushtet. Ky vendim do duhet të konsiderohet për 4 vitet e ardhshme. Nuk besoj se mbingarkon Këshillin marrja e një vendimi formal se kush plotëson kushtin formal të pranimit në shërbimin civil.

**Brikena Ukperaj:** Ilir, kjo që thua nuk gjen mbështetje nënligjore në fakt. Nuk ka Këshilli ndonjë detyrim që të marrë një vendim skualifikimi nga lista e Shkollës së Magjistraturës.

**Ilir Toska:** Ai që nuk plotëson kriterin do duhet të skualifikohet apo është prapë kandidat ai derisa të marri një vendim dikur.

**Brikena Ukperaj:** Ai mbetet në listën e Shkollës së Magjistraturës dhe në momentin kur ti hap një vend vakant në shërbimin civil, ndjek listën dhe sigurisht përfshin ata kandidatë që kanë mbi 70% të pikëve sepse jo domosdoshmërisht renditja në listë automatikisht është prioritare sepse ligji vendos edhe disa kritere të tjera, siç janë

“përvoja specifike në fushën...” apo “përvoja e përgjithshme profesionale” e kandidatit. Unë kështu mendoj që të merret vendim skualifikimi nga lista.

**Ilir Toska:** Nuk është nga lista. Skualifikim nga pranimi në shërbimin civil. Lista është listë. Është thjesht një fakt që duhet ta konsiderojë Këshilli në çdo rast kur pranon në shërbimin civil. Skualifikimi nga pranimi në shërbimin civil është vendim me efekte juridike. Ka të drejtë ta ankimojë. Ne duhet ta bëjmë që në krye të erës. Nuk mund të marrim vendimet pas 4 vjetësh dhe të themi ai është në listë por ne nuk e shqyrtojmë listën se do e shqyrtojmë kur të kemi nevojë.

**Brikena Ukperaj:** Sigurisht!

Marrim variantin që ju propozoni, që duhet të marrim një vendim për skualifikimin nga emërimi në shërbimin civil. Po për emërimin, për kualifikimin për emërimin në shërbimin civil duhet ta marrim vendimin?

**Ilir Toska:** Po! – duhet ta kualifikojmë dhe kur të kemi nevojë për emërim...

**Brikena Ukperaj:** Nuk parashikohet Ilir.

Neni 59 thotë për vendin e lirë për kancelar, për këshilltar dhe ndihmës ligjor, pas procedurës së lëvizjes paralele, kandidatët e renditur në listën e kandidatëve për pozicion kanë të drejtë të paraqesin kërkesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nuk thotë që duhet edhe të jetë të kualifikuar për t’u pranuar në shërbimin gjyqësor civil. E verifikon në atë moment. Ti i merr kandidatët; shikon a i kanë marrë 70% të pikëve apo jo; plotësojnë dhe kriteret e tjera dhe i emëron. Sigurisht që është ngarkesë sepse do kryhen procedura dhe do përcaktojmë relator për secilin kandidat dhe për të njëjtin kandidat...

**Ilir Toska:** Jo, jo! –të lutem, je keqkuptuar.

Nuk ka relator për secilin kandidat. Ka relator për çdo kategori kandidatësh.

Pra një nga anëtarët merr listën për këshilltarë dhe bën një relacion dhe thotë, kanë kaluar 10, ka ngelur 1. Dhjetë kualifikohen dhe një skualifikohet. Ky është akti formal i Këshillit. Nuk ka ndonjë procedurë të madhe.

**Brikena Ukperaj:** Dakord!

Unë edhe pas sqarimit të Ilirit vlerësoj që Kreu VII i rregullores nuk është i nevojshëm për t’u parashikuar sepse automatikisht, me dërgimin e listës nga Shkolla e

Magjistraturës, lista qëndron në Këshill për 4 vjet, madje përditësohet çdo vit nëse do të ketë konkurrime të tjera dhe në eventualitetin që Këshilli do të shpallë vende vakante për në shërbimin civil, do të marrë nga lista kandidatët që janë, pa qenë e nevojshme ta bësh paraprakisht se cilët skualifikohen dhe cilët kualifikohen.

**Naureda Llagami:** Ka kërkuar fjalën Erjoni.

**Erjon Muharremaj:** Ju kërkoj ndjesë nëse është e paqartë.

E kisha fjalën për pikën e dytë të rendit të ditës. Thjesht e shkrova paraprakisht për të kërkuar fjalën. Jo për këtë çështje.

**Naureda Llagami:** Atëherë, lidhur me këtë pjesë, propozimin që ka Brikena.

Ka ndonjë mendim tjetër?

**Brunilda Kadi:** Mundem unë Kryetare?

**Naureda Llagami:** Po!

**Brunilda Kadi:** A dëgjohem?

**Naureda Llagami:** Po! – dëgjohesh.

**Brunilda Kadi:** Atëherë, pavarësisht se unë mendoj që të dyja variantet që folën kolegët kanë argumenta, më shumë do shkoja me variantin që jep zoti Toska, me një arsytim praktik. Këta kandidatë, është mirë që ta dinë që në fillim që nuk i plotësojnë kriteret dhe mos të jenë gjithë kohës së varur në momentin kur do t'iu duhet të kandidojnë dhe atëherë mund të kenë një përgjigje negative. Kështu që do shkoja më tepër me variantin që propozohet nga Komisioni. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit Bruna!

Thejst për qartësim ndoshta nga të gjitha këto diskutime.

Pjesën e listës se si do të dalin rezultatet çdo kandidat do ta kuptojë se nëse kualifikohet apo nuk kualifikohet sepse është një listë që do ta publikojë Shkolla e

Magjistraturës dhe që ato që nuk e kanë kaluar pragun, pa diskutim janë të skualifikuar. Pyetja ime është: Do kemi ndonjë procedurë ekstra lidhur me verifikimin e këtyre kritereve që parashikohen apo thjesht është një procedurë formale për efekte të Këshillit?

**Ilir Toska:** Procedura është formale sepse vendimin nuk e merr Shkolla e Magjistraturës. Shkolla bën testimin. Rezultatet e testimit na i sjellë ne. Ne duhet të marrim vendimin formal. Nuk mund ta marrë shkolla. Ai që skualifikohet nuk mund t'i thuash që ti e di, s'i more pikët dhe prandaj ti je i skualifikuar që në krye të herës.

Nuk besoj se është një procedurë kaq e ngarkuar kjo që parashikohet tek Kreu VII. Thjesht relatori do marrë rezultatet e shkollës dhe do i bëjë prezent në Këshill, këta plotësojnë kushtin, këta s'plotësojnë kushtin. Nëse kjo është një mbingarkesë e madhe, nuk e kuptoj?!

**Brikena Ukperaj:** Ilir, mund të sqaroj dhe diçka?

Në fakt shkolla sjell vetëm kandidatët fitues. Shkolla nuk të sjellë listë me kandidatët jo fitues, siç na vjen edhe lista për magjistratët.

Pika 8 e nenit 53, thotë që shkolla sjell listën, të cilën e miraton, e publikon në faqen zyrtare dhe ia jep Këshillit. Pra ne çfarë do bëjmë me këtë vendimin? Thjesht do përsërisim atë që ka bërë shkolla sepse nuk kemi kompetencë më verifikimi. Nëse ai ka marrë 70% apo jo e përcakton shkolla se kush është fitues.

**Ilir Toska:** Të lutem, shkolla nxjerr rezultatet. Vendimin formal kush hyn në shërbim dhe kush nuk hyn e merr Këshilli. Nuk është kompetencë e shkollës.

**Brikena Ukperaj:** E merr Këshilli në mënyrë të individualizuar kur ka pozicionin e lirë Ilir, nuk e merr paraprakisht Këshilli që ti kualifikohesh kur unë ta hapë atë pozicionin.

**Ilir Toska:** Mirë. Mbajini të jenë të gjithë në garë dhe në fund themi që ju s'ishit në garë që në fillim. S'ka problem. Dhe vazhdojmë.

**Brikena Ukperaj:** Kryetare, unë vazhdoj t'i qëndroj propozimit që Kreu VII është i panevojshëm për të qenë pjesë e këtij projektvendimi (pra pikat 93, 94, 95, 96, 97) në vlerësimin tim janë të panevojshme.

**Naureda Llagami:** Atëherë, përpara se ta kalojmë të gjithë rregulloren, kalojmë propozimin e Brikenës për heqjen e Kreut VII lidhur me procedurat e verifikimit të kandidatëve për në shërbimin civil. Kalojmë në votim.

**Maksim Qoku:** Kryetare, për të sqaruar, se pata shkëputje.

Çfarë po kalojmë në vendim?

**Naureda Llagami:** Atëherë, Brikena ka bërë një propozim.

**Maksim Qoku:** Po! – dëgjova.

**Naureda Llagami:** Po kalojmë në votim propozimin e Brikenës përpara se të kalojmë propozimin në tërësi të rregullores për miratim.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Kundër.

**Dritan Hallunaj:** Kundër.

**Illir Toska:** Kundër.

**Fatmira Luli:** Kundër.

**Marçela Shehu:** Kundër.

**Erjon Muharremaj:** Kundër.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Kundër.

**Naureda Llagami:** Pro.

Atëherë, propozimi i Brikenës rrëzohet.

Kalojmë në miratimin e projektregullores sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

**Maksim Qoku:** Dakord me aktin, përveç klauzolës që votova kundër.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

*Ilir Toska:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Erjon Muharremaj:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Në kushtet kur Këshilli nuk e pranoi propozimin, jam dakord me projekt-aktin. Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Pro.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e vendimit “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për Kancelar, për Këshilltar ose për Ndhmës Ligjor”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 12.10.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve në investime për realizimin e sistemit elektronik të Organizatave Jofitimprurëse, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)



**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Alban Toro**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 5. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 6. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 7. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 8. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe Projekti i USAID.**

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve në investime për realizimin e sistemit elektronik të Organizatave Jofitimprurëse, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Naureda Llagami:** Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës e cila ka të bëjë me miratimin e rishpërndarjes së fondeve në investime për realizimin e sistemit elektronik të Organizatave Jofitimprurëse, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Siç jeni në dijeni, ky projekt-akt ka qenë në mbledhjen plenare të datës 17 shtator dhe gjatë shqyrtimit në këtë seancë nga ana e zotit Toro u kërkua që përpara se të kalojë miratimi i këtij projekt-akti, t’i kërkohet një mendim i specializuar EURALIUS-it dhe Projektit “Drejtësi për të gjithë” të USAID-it, një oponencë mbi projektin e regjistrit

elektronik të OJF-ve të kryer nga vetë gjykata e Shkallës së Parë Tiranë. Kjo kërkesë i është përcjellë projekteve dhe ana e EURALIUS-it ka ardhur një opinion mbi këtë, kurse nga ana e Projektit “Drejtësi për të gjithë”, në kushtet që ky projekt nuk kishte ekspertizë në këtë çështje, është shprehur parimisht dakord me mendimin e EURALIUS-it.

Besoj se aktet ju janë shpërndarë.

Nuk e di, zoti Muharremaj e doni në këtë moment fjalën apo më pas?

**Erjon Muharremaj:** Nëse nuk ka ndonjë kërkesë tjetër, doja të sqaroja diçka zonja Kryetare, nëse mundem.

**Naureda Llagami:** Patjetër!

**Erjon Muharremaj:** Faleminderit!

Në vijim edhe të sqarimit tuaj, pas marrjes së opinionit nga Misioni EURALIUS, ën të konstatohet që mendim i tyre është që është vështirë të japin një opinion të saktë sa i përket vlerësimit të kostos së zhvillimit, zbatimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të ri që përfshihet në studimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe në fakt, ne sot jemi mbledhur pikërisht për miratimin e rishpërndarjes së fondeve dhe unë gjykoj që jemi në pamundësi për të vendosur në lidhje me rishpërndarjen e fondeve pa ditur fillimisht koston e zhvillimit për këtë sistem të ri dhe arsyet për këtë, sipas studimit, proceset e biznesit që do mbulohen nga sistemi nuk janë përshkruar në detaje të mjaftueshme dhe nuk ka gjithashtu detaje të mjaftueshme për të gjitha integritet e kërkuara me regjistrat shtetëror; si dhe në lidhje me migrimin e të dhënave; si dhe nuk del qartë nga studimi se në cilën shtrirje do duhet të përpunohen informacionet financiare të siguruar nga organizatat jofitimprurëse; gjithashtu edhe infrastruktura harduer (hardware) që do duhet të prokurohet nuk është e detajuar sa duhet.

Në dijeninë time nuk ka ndonjë zhvillim pranë Kuvendit ku është paraqitur në fakt projektligji, të paktën nga faqja e internetit të Kuvendit është paraqitur për shqyrtim projektligji “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, një projekt me 52 nene, disa prej të cilëve parashikojnë edhe detyra për Këshillin e Lartë Gjyqësor për sa i përket formatit dhe disa formularëve të caktuar, dhe në këto kushte gjykoj që së pari, përpara se

të diskutojmë mbi studimin për Regjistrin Elektronik të OJF, do duhet të diskutojmë mbi variantet e ndryshme të propozuara nga Misioni EURALIUS, që i kërkuam edhe mendimin.

Në vlerësimin tim personal, unë do isha pro variantit të parë të propozuar nga Misioni EURALIUS, ku Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëse vendos qeveria shqiptare t'i dhurojë një sistem të regjistrimit elektronik që përdoret aktualisht nga Qendra Kombëtare e Biznesit, kështu që shmangen edhe shpenzimet në lidhje me krijimin e një sistemi të ri nga e para, ashtu siç është parashikuar në projektin që na është paraqitur neve nga studimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas këtij versioni i jepet një kopje e pastër e këtij sistemi, që tashmë përdoret nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe pastaj ky instalohet në qendrën e të dhënave që do të instalohet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u përshtatur sigurisht me qëllimet e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse. Kuptohet që sistemi do të përdoret dhe do të mirëmbahet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë - vetëm infrastruktura fizike është e vendosur pranë qendrës së të dhënave që ka Këshilli i Lartë Gjyqësor - dhe kontrollin e plotë mbi përdorimin e tij e ka Gjykata e Rrethit Tiranë, në fakt ashtu siç parashikohet edhe në projektligjin që është duke u shqyrtuar nga Kuvendi. Ky ishte mendimi personal rreth variantit të parë.

Gjithsesi, nga diskutimi ynë do të vendosim se për cilin variant do të konsiderojë më të përshtatshëm Këshilli. Qëndrimi i Këshillit në lidhje me këtë pikë, nëse Kuvendi nuk do ta ketë miratuar ende ligjin, për mendimin tim mund t'i dërgohet Kuvendit edhe në këtë stad, për sa kohë që projektligji nuk ka kaluar ende për shqyrtim në seancën plenare të Kuvendit. Gjykoj edhe që vendimmarrja jonë në lidhje me këtë, do duhet të shtyhet për një moment të dytë, pasi edhe Kuvendi të ketë marrë vendimin në lidhje me draftin përfundimtar që do të miratohet si ligj prej tij. Ndaj, në kushtet që jemi, unë propozoj që si Këshill të diskutojmë mbi variantin e propozuar nga EURALIUS-i dhe pastaj t'i përcillet mendimi Kuvendit. Pra të shtyhet vendimmarrja sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës të caktuar për mbledhjen e sotme. Faleminderit!

*Naureda Llagami: Faleminderit Erjon!*

Atëherë, lidhur me qëndrimin që ka dhënë EURALIUS-i, besoj se e keni lexuar, e keni konsultuar që të gjithë.

Luljeta është “online”. Luli për ty fjala!

**Brunilda Kadi:** Më fal Kryetare, një sekondë!

Erjoni sikur bëri një propozim për të shtyrë vendimmarrjen. Mos ndoshta duhet hedhur kjo në votim apo do ta lëmë kështu?

Me sa kuptova nga diskutimi i Erjonit, propozimi i tij ishte që të shtyheshe dhe t'i çohet Kuvendit projekti për t'u pasur parasysh, përpara se të kalojë përfundimisht drafti-ligji për OJF-të. Mendoj që duhet të diskutohet ky propozimi i Erjonit, apo jo?

**Naureda Llagami:** Dakord! Do ta diskutojmë edhe propozimin e Erjonit, ndërkohë që nëse keni nevojë për të ezauruar detyrën që kemi lënë tek mbledhja pararendëse, çfarë ka thënë EURALIUS-i dhe çfarë duhet të bëjmë lidhur me këtë, besoj se duhet ta kalojmë edhe këtë çështje. Të diskutojmë edhe mbi propozimet e EURALIUS-it dhe në fund mbajmë një qëndrim sepse siç ju kam thënë, ka një VKM të Këshillit të Ministrave e cila ka ngritur një Grup Pune për marrjen e masave, ku një ndër masat është ligji që thotë zoti Muharremaj, i cili i ka ardhur për mendim edhe KLGJ-së dhe masa tjetër që ka të bëjë prapë me Ministrinë e Drejtësisë dhe me gjykatat, bëhet fjalë për ngritjen e sistemit. Përfaqësues në këtë Grup Pune ka qenë vet Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, është përfaqësuar vet në këtë Grup Pune pranë Zëvendëskryeministrit dhe nga shkresat që na kanë ardhur, që i keni bashkëlidhur praktikës, i është kërkuar Këshillit që të marrë masa për mundësimin e këtij projekti. Në zbatim të këtyre shkresave, duke qenë edhe në dijeni të faktit të përmbajtjes të projektligjit, duke qenë në dijeni të faktit që kemi dhënë mendim mbi projektligjin dhe e kemi përcjellë tek autoritetet përkatëse dhe projektligji është në Kuvend, nga ana tjetër, nga Këshilli janë marrë masat, të paktën nga Sektori i Departamentit të Administrimit të Buxhetit, për të vijuar me këtë sepse është kërkuar nga ky Grup Pune.

Nëse juve, pas mendimit të EURALIUS-it, se projektligji ka qenë edhe me datë 17 shtator në Kuvend në pritje për t'u miratuar, pra nuk është një fakt që ne jemi vënë

tani në dijeni. Jemi vënë në dijeni që në momentin që na e kanë përcjellë për mendim këtë projektligj. Kështu që unë vlerësoj që hajde ta diskutojmë në makro dhe çfarë ka thënë EURALIUS-i dhe të marrim një vendim për të gjithë situatën.

**Brunilda Kadi:** Kryetare, dakord. Për ligjet dhe aktet nënligjore nuk na vini ju në dijeni neve se prezumohet që i dimë, së pari. Së dyti, ishte një diskutim procedural dhe unë mendoj që ajo duhet të hidhet në votim së pari sepse u thanë të gjitha arsyet nga zoti Muharremaj. Unë kështu e vlerësoj, që në fillim duhet të hidhet në votim ajo që propozoi zoti Muharremaj.

Sa për opinionin e EURALIUS-it, ne të gjithë e kemi, na është dërguar, e njohim. Luli do ta lexojë opinionin e EURALIUS-it tani, se nuk e kuptova?

**Naureda Llagami:** Nëse ju keni nevojë që të sqaroheni. Nëse ju s'keni nevojë, dakord, kalojmë në votim propozimin e Erjonit dhe kaq.

**Erjon Muharremaj:** Mund të them diçka?

**Marçela Shehu:** Erjon, të lutem, përpara se të marrësh fjalën, dua të saktësoj diçka, ne duhet të diskutojmë rreth propozimeve të EURALIUS-it për të bërë një propozim apo për të mbajtur një qëndrim apo për të na çuar në vendimmarrje? Për çfarë duhet të diskutojmë rreth varianteve që na ka dhënë EURALIUS? Kjo do të na mundësojë që ne të disponojmë me vendim për pikën e dytë të rendit të ditës?

**Erjon Muharremaj:** Atëherë, propozimi im është që të shtyhet vendimmarrja për shkak se siç referova...

**Marçela Shehu:** Pra mos kemi një vendim sot.

**Erjon Muharremaj:** Propozimi im është ky: Të mos marrim vendim, në kushtet kur studimi ka disa mangësi që lidhen me përcaktimin e kostove. Vendimi i sotëm duhet

të jetë për transferim fondesh. Si mund të marrim vendim për transferim fondesh kur nuk dimë se sa fonde duhen. Ky ishte qëndrimi im.

**Marçela Shehu:** Dhe për këtë ju propozoni që ne të kërkojmë asistencë të mëtejshme, pra të kërkojmë detajim të këtij propozimi që ka bërë EURALIUS?

**Erjon Muharremaj:** Për mua propozimi i EURALIUS-it është i qartë.

**Marçela Shehu:** Detajimin kush do ta bëjë? - Që të jem edhe unë e qartë në vendim.

Domethënë, kush do ta bëjë detajimin e këtyre elementëve që ju përmendët?

**Erjon Muharremaj:** Detajimin e elementëve duhet ta bëjë propozuesi, pra Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nëse ju doni sqarime të tjera në lidhje me mendimin e EURALIUS-it, mbledhjen aktualisht janë duke e ndjekur edhe ekspertët e Misionit. Janë zotërinjtë Albano Qojle dhe zoti Erton Karagjozi. Nëse juve kërkoni ndonjë mendim prej tyre, mund të na japin sqarim edhe ata, se janë duke e ndjekur mbledhjen.

**Marçela Shehu:** Jo! – në fakt unë nuk është se po kërkoja detajime në këtë moment. Më shumë doja të kuptoja çfarë do votojmë, pra si do procedojmë sot në mbledhje. A do shtyjmë mbledhjen sepse ky projekt i paraqitur ka nevojë për detajim? Do ta diskutojmë në parim për të bërë ndonjë propozim lidhur me ligjin? Domethënë unë nuk jam shumë e qartë se çfarë po propozohet për të disponuar sot. Prandaj po e bëj këtë diskutim.

**Erjon Muharremaj:** Unë propozova shtyrjen e vendimmarrjes në lidhje me pikën 2 të rendit të ditës.

**Marçela Shehu:** Dakord!

Mirë atëherë, unë propozoj që të hidhet në votim propozimi i Erjonit dhe më pas të kalojmë në diskutimet e varianteve të EURALIUS-it, nëse ky propozim nuk kalon.

**Naureda Llagami:** Erjon, thjesht për saktësi.

Kërkon shtyrjen e vendimmarrjes, duke qenë që projektligji nuk është miratuar akoma nga Kuvendi?

**Erjon Muharremaj:** Duke qenë se studimi i paraqitur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka ato mangësi që i ka evidentuar opiniononi i Misionit EURALIUS.

**Naureda Llagami:** Atëherë, në qoftë se keni...

**Brunilda Kadi:** Më fal, mund të them edhe unë diçka, përpara se të kalojmë në votim, të lutem.

**Naureda Llagami:** Bruna të lutem, se e kam fjalën unë. Ta mbaroj, vazhdo! Se nuk e kam mbaruar fjalën, të lutem.

**Brunilda Kadi:** Më fal! Kujtova se po e hidhje në votim prandaj.

**Naureda Llagami:** Jo, jo! – të lutem ta mbaroj.

**Brunilda Kadi:** Kur të mbaroni, kërkoj unë fjalën.

**Naureda Llagami:** Patjetër!

Erjon, për të qenë të saktë, nëse e kuptuam të gjithë diskutimin. Kemi dy situata. Kemi situatën e parë që është projektligji, që ashtu sikurse jua bëra dijëni të gjithëve, projektligji ka qenë që në momentin që është propozuar projekt-akti. Kemi situatën e dytë, që me të drejtë, anëtarët, në mbledhjen e kaluar thanë, që ky lloj propozimi që na ka ardhur nga kjo gjykatë, ka problematika, nuk më duket reale dhe hajde t'i kërkojmë një mendim të specializuar EURALIUS-it. EURALIUS-i sot na ka dhënë një mendim të specializuar. Ka dhënë dy variante në mos gaboj, variantin 1 dhe variantin 2. Nëse neve mendojmë që këto dy variante kanë nevojë që të merren në konsideratë nga Gjykata e Shkallës së Parë, do e konsiderojmë këtë fakt që t'ia çojmë atyre për të rishikuar edhe një herë projekt-propozimin apo do mendojmë thjesht për shkak të ligjit ne ta shtyjme? Këtë dua që ta kem të qartë sepse nuk po e kuptoj mirë pjesën e propozimit Erjon.

**Erjon Muharremaj:** Atëherë, për ta përmbledhur edhe një herë. Propozimi im sa i përket mbledhjes së sotme plenare është që të shtyhet vendimmarrja, në kushtet kur studimi që na është paraqitur për t'u financuar ka mangësi. Këtu mbyllet diskutimi lidhje me mbledhjen plenare.

**Naureda Llagami:** Dakord. Nëse është ky propozimi e hedhim në votim dhe e dyta më pas vendosim se çfarë do vlerësojmë në votim pastaj nëse Këshilli miraton këtë gjë, duhet të lëmë edhe detyra çfarë duhet të bëjmë për të plotësuar këto mangësi.

**Marçela Shehu:** Një sekondë. Këto mangësitë pastaj kush do t'i plotësojë?  
Se i bie që ne po i çojmë dy variante Gjykatës së Tiranës që të zgjedhin ata?  
Unë prapë nuk e kam të qartë se kush do disponojë lidhur me këto mangësi.

**Erjon Muharremaj:** Mundem?

**Naureda Llagami:** Po, Erjon!

**Erjon Muharremaj:** Tani, Kushtetuta ka ngarkuar KLGJ-në për qeverisjen e sistemit gjyqësor dhe është KLGJ që vendos në lidhje me formatin që do duhet të ketë regjistri i Organizatave Jofitimprurëse, sigurisht në zbatim të ligjit që do miratojë Kuvendi i Shqipërisë, por nuk besoj se projektligji do ndryshojë sa i përket variantit që do përdoret. Ligji përcakton drejtimit kryesore dhe pastaj aktet nënligjore i kemi neve detyrimin.

**Marçela Shehu:** Po mirë, mos është më mirë të presim ligjin atëherë?  
Domethënë, këto dy procese afektojnë njëra-tjetrën?

Tani, po të pyes ty Erjon, duke qenë se ke qenë gjithmonë më i azhurnuar me këto punët e teknologjisë. Pra mos është më mirë të presim miratimin e ligjit, që të kuptojmë përfundimisht se çfarë parashikon?

**Erjon Muharremaj:** Unë e përmenda edhe në diskutimin tim që ne do duhet të presim miratimin e ligjit, por ndërkohë nuk kemi pse humbasim kohë dhe midis nesh thashë që është e mira që t'i diskutojmë variantet e propozuara nga EURALIUS-i, për të qenë gati që kur ligji të miratohet, neve të kemi gati edhe aktet nënligjore, vendimmarrjen tjetër që na duhet në lidhje me këtë. Për efikasitet kohore thashë që të vazhdojmë të debatojmë mbi variantet e propozuara nga EURALIUS.



**Marçela Shehu:** Propozimi juaj është që ne të diskutojmë për propozimet por të mos kemi një vendim lidhur me pikën 2. Unë jam dakord që të diskutojmë lidhur me dy variantet e EURALIUS-it, por nëse do të ndjekim atë logjikën që më mirë të presim atë miratimin e ligjit, atëherë ne mos të marrim vendim lidhur me pikën 2, por vetëm të diskutojmë në parim se cila nga variantet e paraqitura nga EURALIUS-i na duket më i përshtatshëm.

**Erjon Muharremaj:** Propozimi im ishte që vendimi i sotëm të jetë shtyrja e vendimmarrjes dhe sa i përket diskutimit në lidhje me versionet e EURALIUS-it, mendoj që nuk është e nevojshme që diskutimet të bëhen në këtë mbledhje plenare, por pasi kjo të ketë përfunduar.

**Marçela Shehu:** Okej! Unë jam dakord. Tani u sqarova.

**Naureda Llagami:** Një sekondë, se shkak i shtyrjes së mbledhjes ka qenë pikërisht me kërkesë për të marrë opinion nga EURALIUS-i, pra nuk mundemi dot që ta mbyllim mbledhjen në momentin që na është kaluar opinionin dhe ne do diskutojmë dhe do marrim mbi këtë opinion. Ky ka qenë shkak...

**Brunilda Kadi:** Kryetare mund ta kem fjalën se kanë kaluar 6-7 dialogje dhe unë s'e kam fjalën akoma. Mundem?

**Naureda Llagami:** Po Bruna, por s'ke shkruar.

**Brunilda Kadi:** E kam shkruar. Edhe qëparë kur replikuam bashkë, thashë që e kam fjalën kur të mbaroni juve.

Së pasi, nuk e përcaktoni juve është mirë apo s'është mirë të mbyllet mbledhja, të shtyhet pika apo ku e di unë çfarë thatë.

Së dyti, nuk jeni ju që vlerësoni ishte e drejtë apo s'ishte e drejtë, se ju keni vetëm votën tuaj. Se po të ishte e drejtë sipas opinionit tuaj, do kishin votuar atëherë ose do ta kishit kërkuar vetë opinionin e EURALIUS-it.

Së treti, e kërkoja fjalën përpara se të hidheshe në votim që të kuptoj se për çfarë po votoj sepse ashtu siç ndërhyri edhe anëtarja tjetër, zonja Shehu, për të kuptuar se çfarë

po bëhet, të njëjtën gjë kisha edhe unë. Më lejoni që ta rithem çfarë kuptova nga ajo që kërkon Erjoni.

Duke qenë se dy variantet e EURALIUS-it në fund/në konkluzion japin një shifër shumë herë më të vogël nga ajo që është propozuar në mbledhjen e parë plenare, duke qenë që edhe varianti i dytë, me sa e kuptoj unë, ndoshta kjo është edhe ideja e Erjonit, përfshi ndryshime në ligj, në konceptin qoftë në Kodin Civil, qoftë në ligjin për OJF-të, sepse bëhet fjalë për një mënyrë komplet të paparashikuar nga ligji për të organizuar atë regjistrin elektronik, unë përsëri po guxoj të mendoj që ajo që tha Erjoni është që përpara se të marrim këtë vendim, t'i diskutojmë këto variante, t'ia çojmë Gjykatës së Tiranës t'i shikojë me syrin e saj dhe mbase arrijmë në kohë që t'i çojmë ndoshta edhe Kuvendit ndonjë sugjerim përpara se të miratojë ligjin, për të përfshirë ndonjë situatë juridike që do të na lejonte të përdornim njërin nga variantet që sjell EURALIUS-i.

Kështu që është mirë të qartësohet. E mbyllim mbledhjen, e shtyjmë pikën, por çfarë do bëjmë, hapat konkretë?

Nëse e kam kuptuar drejt atë që propozoi Erjoni, do isha dakord me këto hapa: Fillimisht ia çojmë Gjykatës së Tiranës dy projektet e EURALIUS-it, të marrë edhe ajo oponencën ose me shoqërinë që ka kontraktuar, që ka bërë projektin e parë apo ndonjë shoqëri tjetër që merret me këtë punë, të na bëjë oponencën dhe të na vijë me një konkluzion konkret. Dhe meqenëse kjo është një kohë shumë e shkurtër që duhet të ketë një vendim, le t'i ketë të shkurtra këto afatet edhe Gjykata e Tiranës, edhe neve të angazhohemi për këtë pjesë. Kështu që, shtyrjen, në qoftë se propozohet për t'u shtyrë vendimmarrja për këtë pikë, do ta sugjeroja për të vijuar me këto hapa që sapo thashë.

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit Bruna.

**Brikena Ukperaj:** Mund të flas dhe unë?

**Naureda Llagami:** Po, Brikena!

**Brikena Ukperaj:** Në vlerësimin tim, nëse ne do të merrnim një vendim sot për transferimin e fondeve, do duhet ta bazonim në një dispozitë ligjore. Për sa kohë është ligji ai që cakton mënyrën e regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse dhe sot nuk ka

ligj, nuk kemi ku ta bazojmë se nuk do ta bazojmë në VKM vendimin që do marrim sot për transferimin e fondeve. Unë jam e mendimit që nuk mund të marrim një vendim pa hyrë në fuqi ligji. Këtë e kam shprehur edhe në një komunikim zyrtar që ne kemi patur me disa anëtarë të Këshillit. Në vlerësimin tim nuk ka asnjë pengesë që puna të vijojë paralelisht, që ne ta kemi një produkt gati dhe në momentin kur ligji miratohet, pra jam dakord me propozimin që bëri edhe Erjoni edhe Marçela, në momentin kur ligji të hyjë në fuqi ne ta kemi në mënyrë automatike punën gati dhe ta miratojmë transferimin e fondeve, qoftë sipas propozimit të EURALIUS-it apo sipas propozimit që na është sjellë për votim.

E kuptoj që kjo mund të sjellë vonesa dhe mund të kemi pengesa në fondet që mund të kemi në dispozicion deri në fund të vitit, por me idenë që ligji do të kalojë shpejt në Parlament, shpresoj që të mos kemi probleme për transferimin e fondeve, me qëllim që ta bëjmë edhe të ekzekutueshëm pastaj ngritjen e regjistrimit elektronik. Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Thjesht për t'ju përmbledhur që të gjithëve. Besoj se Bruna në fakt e tha më saktë nga të gjithë.

Të gjithë jemi dakord që ka një ndryshim ligji.

Të gjithë jemi dakord që ky regjistrimi duhet të bëhet. Nuk diskutohet më baza ligjore sepse ne jemi tek një projekt-akt që po diskuton dhënien e fondeve për të ngritur një sistem pra për ta rregulluar, baza ligjore është një proces tjetër.

Le të hedhim në votim propozimin për shtyrje dhe për t'ia përcjellë më pas Gjykatës së Tiranës mendimin që ka dhënë... sepse gjykata e Tiranës është ajo që kërkon fondin dhe është autoriteti kontraktor.

Le t'i japim kohë Gjykatës së Tiranës të vlerësojë mendimin e EURALIUS-it, të reflektojë nëse ka mundësi dhe të na sjellë një propozim, duke përfituar edhe nga koha, ndoshta është miratuar edhe ligji dhe bëjmë edhe një shkresë për nxitje për miratimin e ligjit.

**Marçela Shehu:** Duhet të kemi të qartë që pa u miratuar ligji, ne nuk mund të ecim më tej. Këtë besoj e thanë të gjithë kolegët në mënyrën e tyre. Pra edhe sikur të përzgjedhë Gjykata e Tiranës një nga variantet, përzgjedhja e Gjykatës së Tiranës nuk do ta bëjë këtë përzgjedhje të detyrueshme për Këshillin për të disponuar me vendim, nëse ligji nuk është miratuar akoma.

**Ilir Toska:** Ajo që desha të thosha është që në fakt edhe ato që ka propozuar EURALIUS-i, në një farë mënyre kanë të bëjnë me përcaktimet që do duhet të bëjë ligji. Mundet që ne të sugjerojmë qëndrimin tonë, qoftë të dy variantet, qoftë njërin, që të përfshihet në një farë mënyre në modalitetet që do përcaktojë ligji, që më pas ne do duhet ta zbatojmë sa i përket regjistrin të Organizatave Jofitimprurëse. Pra jo thjesht t'i përcjellim Gjykatës së Tiranës që të rishikojë propozimin që ka bërë, por edhe Kuvendit të Shqipërisë që të konsiderojë nëse në përmbajtje të ligjit mundet të përfshihen dy nga variantet që ka thënë EURALIUS apo çdo lloj varianti tjetër që ka një kosto më të pranueshme. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Diskutim tjetër?

Atëherë, kalojmë në votim faktin që e shtyjmë diskutimin e kësaj çështjeje për t'ia përcjellë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë?

**Marçela Shehu:** Më fal Kryetare, edhe Kuvendit.

Më duket që propozimi i fundit ishte që t'ia kalojmë edhe Kuvendit edhe Gjykatës së Tiranës, pra që të eci paralelisht procesi. Me sa kuptova nga Iliri tani në fund.

**Naureda Llagami:** Unë nuk e shoh në fakt mënyrën se si do ia çojmë ne Kuvendit projektin që mund të na sjellë ne Gjykata e Tiranës, kur ne në zbatim të ligjit mbi kriteret që vendos ligji për regjistrin, duhet ta zbatojmë këtë gjë.

Këtu jemi në diskutim fondi, pra jemi në diskutim që do hartohet, dhe kur të bëhet hartimi i komplet të dhënave, do jetë sipas kriterëve që do na thotë ligji sepse duhet të ecim paralelisht me këtë.

Nëse ju gjykoni që ne do t'i çojmë Kuvendit një informacion të tillë, mua më fakt më duket i panevojshëm. Më shumë jam tek ideja që tha Bruna, që neve ia kalojmë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe presim se ndoshta ligji miratohet, sesa t'i çojmë Kuvendit këto lloj aktesh tona.

***Erjon Muharremaj: Mundem?***

Ajo që doja të them është që në kuadër të procesit të konsultimit publik të projektligjit edhe pse e kemi kapërcyer këtë fazë dhe kemi dhënë një herë mendim, nuk ka asnjë të keqe për mendimin tim që t'i çojmë një opinion të dytë në lidhje me projektligjin Kuvendit, ku të përfshihet edhe propozimi, jo i EURALIUS-it, por duhet të jetë propozim i adoptuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (EURALIUS-i na ka ndihmuar që të arrijmë në një mendim në lidhje me regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse) dhe t'i bëhet propozimi që nëse e vlerësojnë, të marrin parasysh propozimin që bëhet mbi mënyrën se si duhet të jetë i ngritur ky sistem. Unë prandaj thashë që jashtë kësaj mbledhjeje plenare të diskutojmë mbi opsionet e mundshme, dhashë edhe qëndrimin tim madje. Unë jam pro variantit të parë, ku është e gatshme baza, pra sistemi të jetë i ngjashëm me atë që përdor Qendra Kombëtare e Biznesit, vetëm të marrim softuerin (software)-in, të pastruar nga të dhënat (se nuk na duhen bizneset) dhe të përshtatet në mënyrë që regjistri që përdoret për bizneset, tashmë të përdoret për Organizatat Jofitimprurëse. Dhe pasi të kemi kristalizuar mendimin nëse do jemi dakord me këtë variant apo për variantin tjetër, t'i drejtohem Kuvendit dhe t'i themi që Këshilli i Lartë Gjyqësor mendon që në tekstin e projektligjit, ndoshta mund të mbahet parasysh edhe fakti që regjistri duhet të ketë këtë formë. Nëse ju gjykoni ta përfshini në një nga dispozitat e ligjit. Faleminderit!

***Ilir Toska: Atëherë, po vazhdoj unë.***

Në fakt desha të thosha pikërisht atë që tha Erjoni.

Ne nuk na pengon askush, përkundrazi do duhet të japim edhe opinionin tonë, qoftë edhe të ndryshëm mbase, për një projektligj i cili na ngarkon ne me detyrën. Në këtë kuadër ne s'kemi asnjë pengesë që t'i propozojmë Kuvendit që të konsiderojë një propozim të caktuar tonin, qoftë variantin e parë, qoftë edhe të dy variantet, kushdo që do të konsiderohet i përshtatshëm për Kuvendin, por që për ne të dyja janë të përshtatshëm për sa kohë kosto financiare është më e ulët se ajo që ka ardhur në propozimin fillestar. Kështu që, pjesë e të gjithë shtyrjes duhet të jetë edhe kjo, sugjerimi për Kuvendin. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Dakord. E hedhim në votim pra.

**Maksim Qoku:** Dakord me propozimin.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi në radhë të parë që këtë çështje nuk do ta shqyrtojë dhe e dyta, do t'i kalojë mendimin Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, gjithashtu edhe Kuvendit të Shqipërisë, mbi propozimet që i ka sugjeruar EURALIUS-i.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 12.10.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi propozimin për llojet dhe masat e tarifave gjyqësore dhe procedurën e mbledhjes së tyre”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                             |                          |
|-----------------------------|--------------------------|
| <b>1. Naureda Llagami</b>   | <b>(kryetare)</b>        |
| <b>2. Maksim Qoku</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>3. Medi Bici</b>         | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>4. Fatmira Luli</b>      | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Brunilda Kadi</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>6. Dritan Hallunaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Ilir Toska</b>        | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b>   | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>9. Marçela Shehu</b>     | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>10. Erjon Muharremaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |



*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zoti Alban Toro.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 5. Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 6. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 7. Kelment Greca, Drejtor pranë Drejtorisë së Organizimit të Gjykatave dhe Standardeve.*
- 8. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 9. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe Projekti i USAID.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi propozimin për llojet dhe masat e tarifave gjyqësore dhe procedurën e mbledhjes së tyre”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila edhe kjo nuk është më pak e rëndësishme. Bëhet fjalë për shqyrtimin e një projektvendimi Mbi propozimin për llojet dhe masat e tarifave gjyqësore dhe procedurën e mbledhjes së tyre”.

Siç jeni në dijeni, ligji për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë ka përcaktuar se Këshilli i Lartë Gjyqësor harton dhe propozon llojet dhe masat e tarifave gjyqësore si dhe mënyrën se si mblidhen dhe paguhen këto tarifa. Referuar këtij detyrimi ligjor, në cilësinë e Kryetares kam nxjerrë një urdhër grupi pune për kryerjen e një

studimi për tarifatat gjyqësore, duke marrë parasysh që ky grup pune është krijuar që më përpara se Këshilli të ishte konstituuar. Në përbërje të këtij grupi pune kanë qenë nëpunës të Drejtorisë së Programit dhe Monitorimit të Buxhetit, Drejtorisë së Organizimit të Gjykatave dhe Standardeve, përfaqësues të projekteve që mbështesin KLGJ-në, kryesisht EURALIUS-i, USAID-i. Në vijim të grupit të punës është hartuar një produkt, produkti që ju keni përpara, i cili gjatë kësaj kohe i është nënshtruar një konsultimi si të jashtëm edhe të brendshëm. I është nënshtruar një konsultimi me 38 gjykata në Shqipëri. Nga ana tjetër dhe një konsultimi për sa i përket shoqërisë civile, ku ky projektligj i është përcjellë për mendim 15 shoqatave dhe organizatava joqeveritare të cilat veprojnë në fushën e aksesit në drejtësi, për të marrë një kontribut prej tyre.

Më pas projektvendimi i është përcjellë edhe Ministrisë së Drejtësisë për mendim, në të cilën janë reflektuar edhe propozimet e Ministrisë. I është përcjellë më pas Komisionit dhe Komisioni vjen përpara jush me këtë propozim.

Për më shumë detaje, unë do doja t'ia jepja fjalën zotit Kelment Greca, i cili është marrë me grupin e punës dhe me hartimin e këtij projektvendimi.

***Kelment Greca:*** Përshëndetje zonja Kryetare!

Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit!

Në zbatim të pikës 8, të nenit 5, pikën 3 të nenit 7, pikën 3 të nenit 8, pikën 1 të nenit 10 i Ligjit nr. 98/2017 “Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, është hartuar ky projekt propozim mbi llojin e masave të tarifave gjyqësore për çdo shërbim të ofruar në gjykata.

Ky propozim do i dërgohet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave të përcaktuara nga ligji për miratimin e udhëzimit të përbashkët për tarifatat gjyqësore.

Tarifatat gjyqësore janë në zbatim të ligjit 98/2017, e përcakton Këshillin si hartues, propozues të llojeve të masave si dhe mënyrën si paguhen këto. Masat dhe llojet e propozuara janë bazuar në nivelin minimal dhe maksimal të përcaktuar nga ligji duke respektuar parimin e progresivitetit dhe proporcionalitetit në shkallë të ndryshme të

gjykimit, si dhe duke garantuar efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve gjyqësore dhe mos cenuar aksesin e qytetarëve në drejtësi.

Në punën e grupit është marrë parasysh i gjithë kuadri ligjor që është në dispozicion. Fillimisht kemi nisur nga Kodi i Procedurës Civile. Tarifat gjyqësore përmenden në disa dispozita të Kodit të Procedurës Civile, duke marrë rëndësi aplikimi i tarifave gjyqësore për ato shërbime procedurale dhe të tjera, që qytetarët marrin përmes gjykatave.

Shpenzimet gjyqësore përbëhen nga tarifat dhe nga shpenzimet e tjera të nevojshme të gjykimit (sipas nenit 102 të Kodit të Procedurës). Po ashtu shpenzimet për dëshmitarët, përmbaruesit, ekspertët, përkthyesit si dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend, parapaguhet nga pala që i ka kërkuar këto shërbime, në shumën e caktuar nga gjykata. Për rrjedhojë, është K.Pr.C. që përcakton në këtë rast, tarifa edhe për shërbimet e sipërpërmendura (nenit 106).

Kodi parashikon gjithashtu, aplikimin e tarifave shtesë në rastet kur palët ndërgjyqëse shkaktojnë vonesa pa shkaqe të arsyeshme në gjykimin e çështjeve (neni 107). Kur palët në gjykim kërkojnë transkriptimin e procesverbaleve, masa e tarifës që aplikohet përkundrajt këtij shërbimi, përcaktohet në nenin 118/b të K.Pr.C.

Në rastin e paraqitjes së një kërkesëpadie në gjykatë ligji procedural (nenet 154/dh dhe 156/b), parashikon që pala paditëse të paguajë si dhe të paraqesë aktin provues të pagimit të tarifës së padisë, i cili përfshin tarifën dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore. Në përfundim, pika III e nenit 310, përshkruan elementët e pjesës urdhëruese të një vendimi gjyqësor, ku përmendet se cilës palë në gjykim i ngarkohen shpenzimet gjyqësore, pjesë e pandarë e të cilave janë edhe tarifat gjyqësore.

Neni 35 i K.Pr.C., bën klasifikimin e gjykimit të padive me 3 dhe 1 gjyqtarë. Gjykimi i padive me 1 gjyqtar shkon për paditë me vlerë 150,000 lekë, të cilësuar si padi me vlera të vogla. Nisur nga ky parashikim procedural, mendojmë se kufiri ndarës për aplikimin e tarifave gjyqësore fikse dhe progresive të dhëna me %, duhet të jetë vlera 150,000 lekë. Për vlera më të ulëta se 150.000 lekë, do të aplikohen tarifa gjyqësore fikse,

ndërsa për vlera më të larta tarifimi do jetë me % sipas natyrës dhe rëndësisë së mosmarrëveshjes së paraqitur në gjykatë.

Ligji nr. 9975, “Për taksat kombëtare” është aplikuar deri më sot. Ky ligj përkufizon "tarifën kombëtare" dhe "pagesat për aktet dhe pullën". Ndërsa vetë tarifatat gjyqësore përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë.

Ndërkohë, caktimi i tarifave gjyqësore në gjykata gjatë kësaj periudhe, është kryer nëpërmjet Udhëzimit nr. 33, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë dhe noterisë”, i ndryshuar. Në bazë të këtij udhëzimi përcaktohet që institucionet përkatëse të gjykatës, Ministrisë së Drejtësisë dhe prokurorisë, për shërbimet që ofrojnë, përfitojnë 10% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që kanë arkëtuar.

Ligji nr. 98/2017 “Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”.

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Ligjin nr. 98/2017 i botuar në Fletore Zyrtare nr. 225, datë 22.12.2017. Për herë të parë në Shqipëri, kemi një ligj të veçantë mbi rregullimet kryesore për tarifatat gjyqësore. Ky ligj, ka si prioritet rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor si dhe përmirësimin e shërbimit dhe të financimit të tij. Ligji është pjesë e një pakete ligjore që synon përmirësimin e aksesit në drejtësi, uljen e mbingarkesës së gjykatave si dhe ofrimin e një shërbimi më të mirë për përdoruesit e gjykatës.

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e përgjithshëm të kategorive të tarifave për veprimet dhe shërbimet e ofruara nga administrata gjyqësore. Gjithashtu, ai përcakton tarifatat minimale dhe maksimale, duke lënë fleksibilitet vetëm në caktimin e masës dhe llojeve të tyre.

Masat e propozuara nga Komisioni, janë vlerësuar financiarisht të përballueshme nga përdoruesit e gjykatave dhe kjo duke marrë në konsideratë se një pjesë e tyre mbulohen nga buxheti i shtetit. Ky është rasti i mbulimit të shpenzimeve të ofruara në kuadër të ndihmës juridike detyrore falas të garantuar nga shteti për subjektet përfituese të saj, në përputhje me Ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” parashikon përjashtimin nga pagesa e tarifave gjyqësore të subjekteve përfituese duke e cilësuar si një nga format e dhënies së ndihmës juridike.

Ai ka parashikuar mundësinë për të përjashtuar nga pagesa e tarifave gjyqësore personat që provojnë se kanë të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet, në çështjet administrative dhe civile. Të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara me numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50% e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Të ardhurat e një personi, i cili nuk jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

Personat, të cilët kanë të drejtën për të marrë ndihmë juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, gëzojnë të drejtën për përjashtim nga pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.

Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet: a) së bashku me kërkesën për ndihmë juridike dytësore; b) bashkëlidhur kërkesë padisë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural; c) në çdo fazë të procesit, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor.

Komisioni i ngritur për përcaktimin e tarifave ka marrë në shqyrtim edhe një analizë që i bëhen të dhënave financiare nga baza e të dhënave që ka pasur ish-ZABGJ-ja në vitet 2010-2018.

Projekt propozimi detajon dhe përcakton në përputhje me Ligjin nr. 98/2017, si padi me vlerë të përcaktuar kërkesëpaditë vlera e të cilave nuk e tejkalon shumën 150,000 lekë (padi me vlerë të vogël), dhe ato pa vlerë, për të cilat do të aplikohet një tarifë fikse. Ndërkohë, që padi me vlerë, konsiderohen ato kërkesëpadi që kanë vlerë më të lartë se ky kufi, tarifimi i të cilave do bëhet në % bazuar në natyrën dhe rëndësinë e mosmarrëveshjes së paraqitur në gjykatë.

Gjatë periudhës kohore 2010 - 2018, në sistemin e drejtësisë janë aplikuar dy udhëzime mbi tarifën gjyqësore.

Nga viti 2010 deri në vitin 2013, tarifa në përqindje (%) ka qenë 3% e vlerës së padisë, ndërkohë që tarifa fikse ka qenë 3,000 mijë lekë.

Ndërsa për periudhën 2014 - 2018, tarifa në përqindje (%) ka qenë 1% e vlerës së padisë, ndërkohë që tarifa fikse ka qenë 3,000 mijë lekë.

Në një tabelë që është bashkëlidhur relacionit (tabela nr. 1) janë të dhënat mbi totalin e numrit të çështjeve dhe të ardhurat e realizuara për kërkesëpaditë me vlerë në %.

Nga krahasimi i të dhënave të ilustruara në tablën 1, evidentohet një rritje e numrit të çështjeve me përafërsi 40% që nga momenti i uljes së tarifës nga 3% të vlerës së saj në 1%. Kjo rritje e numrit të çështjeve sjell dhe rritjen e arkëtimeve pothuajse në të njëjtën masë, me afërsisht 40%. Pra rritja e numrit të çështjeve është në përpjesëtim të drejtë me rritjen e të ardhurave.

Ky trend rritës evidentohet veçanërisht gjatë shqyrtimit të të dhënave për vitet 2013 dhe 2014, të cilat janë vitet kufi ku aplikohet ndryshimi i tarifës nga 3% në 1%, dhe nga ku impakti i këtij ndryshimi është më i dukshëm.

Për analogji me sa më sipër, është e pritshme që rritja e tarifave gjyqësore (që ndodh në mënyrë progresive në shkallët më të larta të gjykimit), do të sjellë uljen e numrit të çështjeve gjyqësore dhe për rrjedhojë uljen e ngarkesës në këto gjykata. Kjo, kryesisht pritet të ndodhë në apel ku tarifën propozohen të rriten në krahasim me tarifën më parshme.

Në tabelën nr. 2 është totali i të ardhurave që përfiton pushteti gjyqësor nga pagesa e tarifave gjyqësore. Totali i të ardhurave që merr është 2% të buxhetit të përgjithshëm të pushtetit gjyqësor, duke luajtur një rol jo të qenësishëm në plotësimin e nevojave buxhetore të sistemit. Ndaj, edhe propozimi për uljen e tarifave në shkallë të parë sipas projeksioneve aktuale nuk pritet të ketë ndonjë impakt të dukshëm në buxhetin gjyqësor.

Duke qenë se, sistemi i tarifave gjyqësore aktuale nuk reflekton shpenzimet për funksionimin e gjykatave dhe taksapaguesit ngarkohen me barrën e mbajtjes së këtij

shërbimi, ky propozim ka për synim kalimin e kësaj barre, për sa të jetë e mundur, te palët ndërgjyqëse që iniciojnë procesin gjyqësor.

Gjithashtu, bazuar në një skanim të tërthortë të sistemit aktual gjyqësor, rezulton se të ardhurat e gjeneruara nga tarifat gjyqësore ndonëse mbledhen nga vetë gjykatat, në disa raste nuk përdoren në mënyrë eficiente prej tyre. Si rrjedhojë, vlerësohet e nevojshme që administrimi i këtyre të ardhurave të realizohet nga një autoritet i vetëm përgjegjës, i cili do të alokojë fondin sipas nevojave përkatëse që paraqesin gjykatat, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës dhe të shërbimit në këto gjykata. Komisioni vlerëson se autoriteti përgjegjës në këtë rast mund dhe duhet të jetë vetë KLGJ-ja.

Tek tabelat e mëposhtme janë të ardhurat (tabela 3 dhe 4) të mbledhura në përqindje sipas viteve 2014-2018 ku evidentohet rritje e çështjeve gjyqësore gjatë periudhës 2014-2018. Rritja e numrit të çështjeve pasohet me ulje të të ardhurave të buxhetit gjyqësor. Kjo nënkupton që me uljen e tarifës gjyqësore është rritur aksesin e publikut në gjykata, gjë e cila dëshmohet nga rritja e numrit të çështjeve. Ndërsa nga pikëpamja financiare rezulton të kemi ulje të të ardhurave të gjeneruara nga mbledhja e tarifës gjyqësore. Pavarësisht kësaj uljeje, impakti që ajo sjell në buxhetin gjyqësor është i papërfillshëm duke marrë në konsideratë që të ardhurat e gjeneruara nga tarifat gjyqësore zënë vetëm 2% të buxhetit të përgjithshëm gjyqësor.

Peshën specifike më të madhe, si të numrit të çështjeve, ashtu edhe të të ardhurave të gjeneruara e zënë gjykatat e Tiranës, rreth 4 herë më të madhe se totali i gjykatave të tjera të marra në këtë analizë.

Pesha e të ardhurave në % për çdo fashë të kërkesëpadive kundrejt totalit (tebala nr. 6) që jep një pasqyrim të qartë se çfarë peshe zë secila tarifë sipas fashae që janë propozuar në projekt propozim.

Ajo që vërehet nga analiza është se numri më i madh i çështjeve i takon fashës nën 200,000 lekë, me një peshë mesatare 30% kundrejt totalit të çështjeve, e ndjekur nga fasha 200,000 - 1,000,000 lekë me 29%. Numri më i vogël i çështjeve i takon fashës së fundit me mbi 20 milion lekë, që zënë një peshë mesatare 3% kundrejt totalit të tyre.

Për sa i takon të ardhurave rezulton se peshën më të madhe të tyre e zënë kërkesëpaditë me vlerë më të madhe se 20 milion lekë, mesatarisht zë 38% të të ardhurave totale. Ndërsa, peshën më të vogël e zënë kërkesëpaditë me vlerë më të vogël se 200,000 lekë, mesatarisht 6% të totalit. Pra, rezulton që ka një raport të zhdrejtë midis vëllimit të çështjeve dhe peshës së të ardhurave që përftohet nga kërkesëpaditë me vlerë në %. Kjo nënkupton që kërkesëpaditë pa vlerë dhe me vlerë të vogël, ndonëse zënë vëllimin më të madh të çështjeve gjyqësore, në terma financiare gjenerojnë të ardhura më të ulëta sesa kërkesëpaditë me vlerë më të lartë.

Propozimi i uljes së tarifës për kërkesëpaditë me vlerë nën 200,000 lekë do të sjellë një impakt pozitiv në rritjen e aksesit në gjykata, dhe nuk do të ketë ndikim tek të ardhurat e gjykatës për shkak të peshës së vogël (6%) që zënë këto të ardhura ndaj totalit . Ulja e të ardhurave që do të rezultojë nga aplikimi i tarifës fikse të propozuar, do të kompensohet nga tarifa që do arkëtohet nga apelimi. Tarifa në këtë shkallë të dytë të gjyqimit propozohet të jetë jo më e ulët se 2,000 lekë (sikurse e parashikon Ligji nr. 98/2017) për kërkesëpadi me vlerë jo më të lartë se 150,000 lekë dhe përtej kësaj fashe tarifa në % propozohet të ndjekë parimin e progresivitetit dhe proporcionalitetit. Nga ana tjetër, paditë që zënë numrin më të vogël prej 18% (kolona 4 dhe 5) të çështjeve gjyqësore përkundrejt totalit të tyre i përkasin fashës mbi 5.000.000 lekë, padi të cilat gjenerojnë të ardhura më të larta në vlerat e 61% të të ardhurave në total (kolonat 4 dhe 5). Kështu nisur nga sa më lart, ulja e tarifës fikse nuk do sjellë efekt negativ në uljen e të ardhurave.

Nisur nga këto të dhëna, propozimi është bazuar mbi ndarjen në fasha sipas vlerave të kërkesëpadive. Kjo ndarje bëhet me qëllimin për të respektuar legjislacionin në fuqi dhe për të siguruar një barazi sociale, duke parashikuar pagesën në % sipas vlerës së kërkesëpadisë.

Gjithashtu, ulja e tarifës fikse të sipërpërmendur për kërkesëpaditë pa vlerë dhe më vlerë të vogël (deri më 150,000 lekë) në masën 50% të tarifës aktuale (3,000 lekë sipas udhëzimit) është bërë duke synuar që të gjendet një kompromis midis aksesit në



drejtësi dhe nevojës për burime financiare për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve gjyqësore.

Treguesit financiarë të nevojshëm për të realizuar një parashikim të saktë mbi efektet financiare që do të sjellë aplikimi i tarifave të ndryshuara, mungojnë për shkak të kufizimeve të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Sistemi aktual nuk gjeneron të dhëna të detajuara mbi llojin e çështjeve dhe përqindjen e tarifave të aplikuar sipas fashave, numrin e çështjeve të apeluara, apo ndarjen e çështjeve sipas natyrës së tyre (civile, penale, administrative). Pavarësisht vështirësisë të parashikimit të saktë të impaktit financiar është përgatitur një projeksion bazuar në të dhënat e 3 viteve të fundit, 2016-2018.

Që mos të zgjatet më shumë, po shkoj tek tabela 9 për të parë se çfarë efekti mund të ketë aplikimi i tarifave të propozuara. Mund të jetë një rritje e të ardhurave në masën 10% të ardhurave aktuale duke u bazuar në të ardhurat e vitit 2018.

Sipas këtij propozimi mbi masën dhe llojin e tarifave gjyqësore, është i pritshëm një impakt financiar të jetë tek këto vlera.

Për një tablo më të qartë të masave dhe llojeve të tarifave gjyqësore që aplikohen aktualisht dhe atyre që propozohen nga Komisioni, mund t'i referoheni Tabelës Përmbledhëse bashkëlidhur këtij relacioni.

Në studimin që është përgatitur ne kemi marrë mendime dhe opinione edhe të Ministrisë së Drejtësisë, rekomandime të Misionit EURALIUS, disa të dhëna të CEPEJ, sugjerime dhe propozime nga sistemi gjyqësor, sugjerime dhe propozime nga Organizatat Jofitimprurëse, sugjerimet nga Ministria e Drejtësisë edhe pas kalimit në Komision dhe këto gjëra i kemi reflektuar në propozimin përfundimtar.

Për ta mbyllur, po lexoj përfundimet e relacionit, që mos të zgjatet shumë me tabelat.

Komisioni, pasi mori në konsideratë kuadrin ligjor në fuqi, studimin e hartuar nga grupi i punës si dhe mendimet e ndryshme të shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë të sipërpërmendura, konkludoi se llojet dhe masa e tarifave gjyqësore mund dhe duhet të vendosen kryesisht brenda kufijve minimalë dhe maksimalë të

përcaktuara në ligj. Ai mbajti në konsideratë si të drejtën e individëve për akses në drejtësi edhe garantimin e të drejtës së ankimit, duke aplikuar tarifa gjyqësore të diferencuara për shërbime të ndryshme në shkallë të ndryshme të gjykimit në përputhje me parimin e progresivitetit dhe proporcionalitetit.

Janë institucionet shtetërore ato që kanë detyrimin të sigurojnë dhe ofrojnë shërbime publike, duke përfshirë këtu dhe shërbimet gjyqësore me qëllim garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave e lirive të qytetarëve. Mundësia e këtyre të fundit për t'iu drejtuar sistemit gjyqësor për të marrë shërbimin e kërkuar lidhet pashmangshmërisht me të drejtën e tyre për akses në drejtësi. Ndaj tarifat gjyqësore të propozuara nuk e pengojnë këtë të drejtë, përkundrazi këto tarifa krijojnë premisa për garantimin e aksesit në drejtësi dhe ofrimin e shërbimeve cilësore.

Shërbimet gjyqësore kanë një kosto financiare, një investim në kohë dhe në burime njerëzore, të cilat duhet të mbulohen, pjesërisht, nga pala që ka investuar gjykatën për një pretendim ligjor. Prandaj ato paguhen paraprakisht nga paditësi dhe nëse rezulton se pretendimi i tij është i drejtë i ngarkohen palës gjyq humbëse për aq sa pranohet padia.

Projekt-propozimi ka si qëllim caktimin e llojeve dhe masave përkatëse të tarifave gjyqësore, duke i ndarë ato në tre kategori, në përputhje me Ligjin nr. 98/2017, dhe përkatësisht në:

- a. tarifa gjyqësore të përgjithshme;
- b. tarifa gjyqësore të veçanta dhe;
- c. tarifa gjyqësore shtesë.

Tarifa gjyqësore e përgjithshme për paraqitjen e kërkesëpadisë përlllogarit mbi bazën e vlerës së padisë për çështje gjyqësore civile dhe administrative. Sikurse është përmendur më sipër tarifat gjyqësore të përgjithshme i ndajmë në tarifa fikse dhe tarifa në përqindje (%). Tarifat fikse i referohen kërkesëpadive pa vlerë ose me vlerë të vogël deri më 150,000 lekë. Ndërsa tarifa gjyqësore në përqindje i referohet kërkesëpadive me vlerë mbi 150,000 lekë.

Sipas pikës 2, të nenit 5 të Ligjit nr.98/2017, masa e tarifave gjyqësore të përgjithshme, është jo më e ulët se 1,000 (një mijë) lekë dhe jo më e lartë se 20,000,000

(njëzet milionë) lekë. Ndërkohë, që masa e tarifave gjyqësore të përgjithshme për gjykimet në gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Lartë është jo më e ulët se 2,000 (dy mijë) lekë dhe jo më e lartë se 10,000,000 (dhjetë milionë) lekë.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme, ku ligji ka përcaktuar tarifën minimale jo më të ulët se 1,000 (një mijë) lekë u konkludua që tarifatat duhet të caktohen në masa fikse, për vlera të kërkesëpadi së që nuk kalojnë vlerën 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Masa fikse e propozuar është 1,500 (njëmijë e pesëqind) lekë ose 50% më e ulët se tarifatat aktuale e parashikuar nga Udhëzimi i përbashkët Nr. 33, datë 29.12.2014, i ndryshuar, e cila është 3,000 (tremijë) lekë.

Kjo tarifë (fikse) është menduar më e ulët në gjykimin e shkallës së parë me qëllim sigurimin e aksesit në drejtësi dhe është rritur respektivisht në mënyrë progresive në vlerën 2,000 lekë në Apel dhe 3,000 lekë në Gjykatën e Lartë (nga 200 lekë që është aktualisht). Kjo rritje në gjykatat e shkallëve më të lartë vjen në përputhje edhe me propozimet e organizatave jo fitimprurëse.

Pika 1, neni 5 i Ligjit nr. 98/2017, përcakton se “Tarifa gjyqësore e përgjithshme për paraqitjen e kërkesëpadi së përlllogarit mbi bazën e vlerës së padisë për çështje gjyqësore civile dhe administrative”. Nisur nga ky përcaktim, propozimi është ndërtuar mbi ndarjen në fasha sipas vlerave të padisë me qëllimin për të zbatuar parashikimin ligjor dhe garantuar një barazi sociale duke parashikuar pagesën në % sipas vlerës.

Për kërkesëpadi që vlera është më e madhe se 150,000 lekë, masa në % në gjykimet në shkallë të parë është bazuar në tarifatat aktuale. Ajo respekton kornizat financiare që përcakton ligji dhe rezulton të jetë një masë e përshtatshme pasi nuk cenon aksesin në drejtësi. Kjo masë në përqindje do të mbetet e njëjtë me atë të parashikuar në aktet nënligjore të zbatueshme që prej vitit 2014, në masën 1% të vlerës së kërkesëpadi së.

Masat janë vlerësuar të përballueshme edhe në raport me vlerën e padisë, duke marrë në konsideratë që një pjesë e këtyre shpenzimeve mbulohet nga buxheti i shtetit.

Për sa i përket, padive për çështje familjare dhe më specifikisht ato me objekt pension ushqimor, caktim kujdestarie, kërkesë për birësim, etj., Komisioni ka parashikuar

që këto padi të jenë pa pagesë (me pagesë 0). Këto tarifa propozohen në vlerën 0 për shkak të sensibilitetit dhe natyrës së këtyre çështjeve dhe marrëdhënieve, dhe faktit që prekin një kategori individësh me të ardhura të pamjaftueshme. Ky propozim gjithashtu vjen në përputhje edhe me opinionin e Ministrisë së Drejtësisë për këtë kategori kërkesëpadish.

Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për një deklaratë noteriale, akt për dhënien e një kredie bankare, vendim gjykate arbitrazhi, etj., gjykata nuk shqyrton bazueshmërinë e themelit të së drejtës që pretendohet, sikurse ndodh në rastin e kërkesëpadisë. Kjo pasi e drejta e përcaktuar në përmbajtjen e titullit ekzekutiv vlerësohet e vërtetuar. Në këtë rast gjykata shqyrton elementët formalë të titullit ekzekutiv. Për këtë arsye propozohet masë tarife më e ulët se pranimi i kërkesëpadive. Masa e propozuar është tarifë fikse 1,000 Lekë dhe 0.5% për kërkesëpadi me vlerë mbi 150.000 lekë.

Ndaj për të gjitha tarifat e propozuara më sipër, Komisioni vlerëson se ato jo vetëm që nuk pengojnë aksesin në drejtësi por e forcojnë atë duke siguruar që gjykatat të gjykojnë brenda një afati të arsyeshëm edhe për individët që përfitojnë nga ndihma juridike.

Për tarifat në gjykatat e Apelit, jemi bazuar në pikën 3, neni 5 i Ligjit nr. 98/2017, ku është përcaktuar se “Masa e tarifave gjyqësore të përgjithshme për gjykimet në gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Lartë është jo më e ulët se 2,000 (dy mijë) lekë....”, gjë e cila është e përcaktuar qartë në draft propozim, si masa minimale ligjore e lejuar. Komisioni në rastin e Gjykatës së Apelit ka propozuar aplikimin e tarifës minimale fikse të lejuar në ligj, të barabartë me 2,000 lekë.

Tarifa në %, është vendosur në mbështetje të pikës 8, neni 5 të ligjit 98/2017, i cili parashikon se tarifat të propozohen mbi bazën e natyrës së çështjes, parimeve të proporcionalitetit dhe progresivitetit.

Nga disa vlerësime të kryera vlen të theksohet se shkalla e ankimit në Shqipëri shkon deri në 98% të rasteve. Gjithashtu tarifa e aplikuar deri më tani prej 200 lekësh,

nuk justifikon bërjen e një apelimi apo rekursi. Duket qartë se në Shqipëri ekziston një kulturë e palëve apo përfaqësuesve të tyre ligjorë që të ankimojnë çdo vendim gjyqësor duke përfshirë këtu dhe ankesa për çështje të pashpresa (dhe pa prova). Në këtë kontekst kulturor, vlerësohet se rritja ose vendosja e tarifave gjyqësore më të larta në apel dhe në Gjykatë të Lartë mund të ndikojë në ndryshimin e kësaj kulture të rrënjosur apelimi. Ai synon uljen e ngarkesës në gjykata dhe reduktimin e stokut të çështjeve të patrajtuara ndër vite.

Vlen të përmendet, se në ndryshim nga udhëzimi i mëparshëm ku tarifa gjyqësore për të gjitha llojet e çështjeve ka qenë e njëjtë dhe e pa diferencuar sipas vlerës, ky propozim synon të bëjë drejtësi sociale duke parashikuar tarifa të ndryshme për çështje të ndryshme. Në këtë aspekt dhe duke qëndruar brenda hapësirave të lejuara ligjore, Komisioni propozon tarifa të cilat nuk cenojnë interesin publik dhe aksesin në drejtësi (tarifë në kufijtë minimal ligjor në apel) duke kryer një rritje progresive të tyre në krahasim me tarifën e vendosura në shkallë të parë.

#### Tarifa gjyqësore e veçantë

Në zbatim të nenit 8 të Ligjit nr. 98/2017 “Për tarifën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, tarifa gjyqësore e veçantë caktohet për shqyrtimin e kërkesave të veçanta procedurale gjatë zhvillimit të gjykimit në të gjitha shkallët e gjykimit dhe në të gjitha juridiksionet gjyqësore, si dhe për shërbime të administratës gjyqësore.

Këto tarifa janë parashikuar jo më të ulëta se 50 (pesëdhjetë) lekë dhe jo më të larta se 2,500 (dymijë e pesëqind) lekë. Masa për llojet e tarifave gjyqësore të veçanta përcaktohet sipas parimeve të proporcionalitetit dhe progresivitetit dhe në proporcion me tarifën e përgjithshme.

Tarifa gjyqësore e veçantë, për shqyrtimin e kërkesave të veçanta procedurale, si kërkesa për shtyrjen e seancës, për përjashtim gjyqtari, etj., parashikohet në nivelin maksimal të saj në gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Lartë, dhe kjo me arsyetimin se shmang në maksimum shtyrjen pa kriter të seancave gjyqësore. Një gjë e tillë passjell zvarritje të gjykimeve përtej afateve të arsyeshme, ndaj caktimi i këtyre tarifave synon të

sigurojë një proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore duke disiplinuar, për aq sa është e mundur, sjelljen e palëve në gjykim.

Tarifa për kërkesat e veçanta procedurale në shkallë të parë propozohet në vlerat e 30% deri në 70 % më të ulëta se vlera maksimale e lejuar nga ligji, pra përkatësisht nga 1,000 lekë deri në 1,500 lekë. Ky propozim vjen në kuadër të zbatimit të parimit të proporcionalitetit dhe progresivitetit, e cila nënkupton që masa e tarifës gjyqësore shtesë vjen në rritje për shkallët e apelit dhe Gjykatës Lartë.

Tarifa gjyqësore e veçantë, për shërbime të administratës gjyqësore, si fotokopje, vërtetime, etj., parashikohet përafërsisht në vlerat e kostove të këtyre shërbimeve të marra nga eksperiencia e ish-ZABGJ-së

Kështu, duke marrë në konsideratë natyrën e kërkesëpadive për të cilat aplikohen tarifa gjyqësore të veçanta, Komisioni vlerëson se aplikimi i një barre financiare për palët ndërgjyqëse i përgjigjet garantimit të lirive dhe të drejtave të tyre duke u dhënë mundësinë për paraqitjen dhe trajtimin e kërkesave shtesë apo/dhe reduktimin e objektit të padisë. Njëkohësisht aplikimi i saj synon disiplinimin e procesit gjyqësor dhe zgjidhjen mosmarrëveshjes në afate të arsyeshme ligjore.

Tarifa gjyqësore shtesë

Si Kodi i Procedurave Civile ashtu dhe Ligji 98/2017 përcaktojnë rastet e aplikimit të tarifave shtesë. Përkatësisht: neni 107 i K.Pr.C., parashikon se “Nëse pala ndërgjyqëse ose përfaqësuesi i saj ka shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme vonesa në gjykimin e çështjes, gjykata kryesisht mund të caktojë një tarifë gjyqësore shtesë, sipas përcaktimeve të ligjit “Për tarifat gjyqësore”. Ligji nr. 98/2017 “Për Tarifat Gjyqësore”, parashtron se tarifa shtesë caktohet në rastet kur pala ndërgjyqëse ose përfaqësuesi ligjor i saj ka shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme vonesa në gjykimin e çështjes. Gjithashtu, në frymën e ligjit procedural (neni 165, K.Pr.C.), në rastet kur dëshmitari ose eksperti nuk paraqitet në gjykatë pa shkaqe të arsyeshme parashikohet dhe aplikimi i një gjobe deri në 30.000 lekë me qëllim penalizmin e vonesave të shkaktuara gjatë procesit gjyqësor.

Dispozitat ligjore të mësipërme dëshmojnë se tarifat gjyqësore shtesë caktohen në funksion të administrimit korrekt të procesit gjyqësor duke synuar parandalimin e

shtyrjeve të paarsyeshme të seancave apo bllokimin e qëllimshëm të procesit gjyqësor. Këto tarifa vendosen sipas diskrecionit të gjykatës, e cila duhet të vendosë mbi shkallën e neglizhencës së palës.

Komisioni, duke marrë në konsideratë kuadrin ligjor në fuqi parashikon përcaktimin e tarifave në masë fikse. Një opsion i mundshëm për masën e këtyre tarifave është ai i ekspertëve të Kuvendit, i përcaktuar në kufijtë nga 10.000 – 50.000 lekë duke u ndarë në fasha sipas gjykatave.

Propozimi për vendosjen e tarifave gjyqësore shtesë ka mbi të gjitha një karakter parandalues. Kjo pasi me vendosjen e një barre financiare mbi palët që shkaktojnë vonesa të paarsyeshme, synon të garantojë një proces sa më të shpejtë gjyqësor. Vonesat në gjykimin e çështjeve gjyqësore prekin në radhë të parë vetë palët në proces, të cilët mund të dëmtohen nga shtyrja e pajustificuar e seancave gjyqësore. Drejtësia e vonuar është një drejtësi e mohuar. Ndaj propozimi i tarifave shtesë synon të sigurojë një proces gjyqësor eficient dhe cilësor për qytetarët.

Mënyra e mbledhjes dhe pagesës së tarifave.

Draft propozimi, përcakton jo vetëm masën dhe llojin e tarifave gjyqësore por edhe mënyrën dhe procedurat e pagesës së këtyre tarifave, mbështetur në informacionin e ardhur nga gjykatat si dhe në përcaktimet e legjislacionit në fuqi. Përkatësisht:

Tarifa gjyqësore e përgjithshme:

Sipas nenit 5 tarifa gjyqësore e përgjithshme, paguhet në momentin e paraqitjes së padisë, të ankimit, të ankimit të veçantë ose të rekursit në gjykatë, përveçse kur ligji parashikon ndryshe. Tarifa paguhet për shërbimet që ofron gjykata që nga momenti kur është depozituar padia në gjykatë dhe përfshin shërbime si: pranimin e kërkesës së depozituar nga K/sekretaria, hedhjen në short, caktimin e seancës, njoftimin e palëve, çeljen e seancës, dëgjimin e palëve nga gjykata, hetimin gjyqësor etj. Të gjitha këto shërbime kanë një kosto financiare, një investim në kohë dhe në burime njerëzore, të cilat duhet të mbulohen pjesërisht nga pala që ka investuar gjykatën për një pretendim ligjor. Prandaj ato paguhen paraprakisht nga paditësi dhe nëse rezulton se pretendimi i tij është i drejtë i ngarkohen palës gjyq humbëse për aq sa pranohet padia.

Tarifa gjyqësore e veçantë:

Për sa i përket kësaj kategorie, ligji ka parashikuar që pagesa e tarifa gjyqësore të veçantë paguhet në kohën e paraqitjes së kërkesës në gjykatë.

Tarifa gjyqësore shtesë

Paguhet 21 ditë kalendarike nga data e njoftimit të vendimit të gjykatës, sipas parashikimit të pikës 2, të neni 7, Ligjit 98/2017.

Do më lejoni që të bëj një përmbledhje të vlerës së kërkesëpadive.

Për pranimin e kërkesëpadive, masa aktuale që paguhet sot është 3 000 lekë – propozohet në masën 1 500 lekë. Masa në përqindje është 1% me paditë me vlerë – propozohet e njëjta me 1% të vlerës së padisë për paditë pa vlerë dhe mbi 150 000 lekë.

Kërkesat për lëshim urdhri ekzekutimi aktualisht tarifa është 3 000 lekë, propozohet 1 000 lekë ose 0.5% e vlerës së kontratës së deklaratës, në qoftë se e tejkalon vlerën e caktuar.

Pranimi i ankimeve është 200 lekë – propozohet 2 000 lekë është në vlerën minimale të lejuar nga ligji.

Pranimi i rekurseve është 200 lekë – është propozuar 3 000 lekë, 0.5% e vlerës së padisë mbi 150 000 – 5 milion lekë, 0.3% e vlerës për padi me vlerë më shumë se 5 milion lekë. Është ndjekur parimi i progresivitetit nga një shkallë apeli në Gjykatën e Lartë.

Kërkesat për shtyrje seance është propozuar vlera 1 500 lekë.

Kërkesë për përjashtim gjyqtari 1 500 lekë.

Rivendosje në afat 1 000 lekë.

Ndryshimi dhe zëvendësimi i sigurimit të padisë 1 000 lekë.

Saktësim objekti të padisë/ Rishikim vendimi 2 000 lekë (këto ishin për shkallën e parë).

Kurse në apel dhe në Gjykatë të Lartë.

Kërkesa për shtyrjen e seancës 2 500 lekë.

Kërkesa për përjashtim gjyqtari/trupi gjykues 2 500 lekë.



Rivendosje në afat 2 000 lekë.

Saktësim objekti padie 2 000 lekë.

Saktësim objekti të padisë/ Rishikim vendimi 2 000 lekë.

Ndërsa për tarifat gjyqësore shtesë - Vonesa në gjykimin e çështjes, shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme në gjykatat e shkallëve të parë të gjykimit – është përcaktuar vlera nga 10 000 lekë – 20 000 lekë; në Gjykatat e Apelit nga 20 000 lekë – 30 000 lekë; në Gjykatën e Lartë nga 30 000 lekë – 50 000 lekë.

Këto ishin pak a shumë tarifat e propozuara, ndërsa ato që nuk u përmendën më lart ishte vetëm pjesa që ka të bëjë me administratën gjyqësore, që është lëshim vërtetimi që është parashikuar në vlerën 200 lekë, aq sa është edhe aktualisht. Kopje e CV-ve, e të gjitha këto të tjerat, punë administrative të sekretarisë, përgjithësisht janë në kostot e këtyre shërbimeve. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, Keli!

Do ftoja kolegët nëse kanë diskutime dhe pyetje mbi propozimin.

**Brikena Ukperaj:** Kryetare, unë kam diçka për të diskutuar.

**Naureda Llagami:** Po Brikena!

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, siç na u tha edhe nga relacioni, ashtu sikundër edhe ju prezantuat, në po miratojmë përmbajtjen e një propozimi që duhet të miratohet me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave. Gjithsesi, akti ynë, edhe pse është një propozim, sigurisht që duhet të kemi përgjegjshmëri në përmbajtjen e këtij propozimi, dhe ajo që unë kam konstatuar ka disa mospërputhje ose kundërshtime me atë çka parashikohet në Kodin e Procedurës Civile. Për shembull, referuar ligjit për tarifat, tarifat ndahen në tarifa gjyqësore të përgjithshme, tarifë gjyqësore shtesë dhe tarifë gjyqësore të veçantë. Në ligj përcaktohet se kush është tarifa gjyqësore e përgjithshme, kush është ajo shtesë dhe kush është tarifa gjyqësore e veçantë. Ligji na detyron që ne të përaktojmë masën e tarifës dhe referuar masës së tarifës për shembull që kemi bërë për tarifën gjyqësore shtesë, kemi përcaktuar vonesa në gjykimin

e çështjeve në gjykatat e shkallës së parë, të apelit dhe në Gjykatën e Lartë, pa shkaqe të justifikuara (flas për civilet). Po të shkojmë tek Kodi i Procedurës Civile, neni 34, që bën fjalë për abuzimin e të drejtave të palëve në proces, parashikon gjobë të përcaktuar për palët që sjellin shtyrje të pajustificuara të seancave gjyqësore, e cila varion nga 50 000 – 100 000 lekë (flas për nenin 34, pika 1, i ndryshuar me ligjin 2017) dhe këtë gjobë e cakton gjykata. Nuk lejon që mund të përcaktohet masa me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor apo me udhëzim të përbashkët.

Në këndvështrimin tim, krijohet një mbivendosje midis nenit 34, pika 1 që përcakton gjobitjen e përgjegjësit me shumën nga 50 000 – 100 000 lekë (për shumë shkelje dhe një nga këto shkelje është edhe zvarritja e pajustificuar e procesit) me tarifat gjyqësore shtesë që ne kemi parashikuar në propozimin tonë. Në fakt e keqja fillon edhe që nga ligji sepse edhe ligji parashikon si tarifë gjyqësore shtesë në fakt rastet kur pala ndërgjyqëse ose përfaqëesuese ka shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme vonesa në gjykimin e çështjes. Mendoj që kjo gjë duhet parë dhe duhet diskutuar.

Çështja tjetër që kam lidhet me disa pagesa që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës apo me detyrimin për ushqim.

Referuar propozimit që ne duhet të miratojmë sot, tarifa e përgjithshme gjyqësore për detyrimin për ushqim është caktuar zero lekë. Në fakt edhe sot, për paditë që kanë të bëjnë me detyrimin për ushqim kaq është taksa mbi aktet. Por referuar ligjit, në fakt ligji, dhe konkretisht i referohem nenit 6 të ligjit, thuhet: Tarifa gjyqësore e përgjithshme paguhet gjatë gjykimit ose përpara dhënies së vendimit përfundimtar vetëm në rastet e mëposhtme: kur çështja gjyqësore ka për objekt dhënien e pensionit ushqimor. Në kushtet kur ligji në mënyrë indirekte pranon që për këtë padi do të ketë tarifë gjyqësore, duhet të përcaktohet një tarifë gjyqësore, qoftë edhe në vlerën minimale. Po kështu, edhe për marrëdhëniet e punës thotë: Për paditë për marrëdhëniet e punës në vlerë deri në 700 000 lekë mund të pranohet që taksa e padisë ose tarifa të merret gjatë gjykimit ose para dhënies së vendimit. Edhe kjo duhet parë dhe duhet ripunuar në akt.

Lidhur me pagesën e tepërt të tarifës së paguar, në vlerësimin tim nuk duhet të jenë pjesë e bashkëpropozimit sepse ne sipas ligjit kemi (ndoshta këtë e vendos gjykata –

taksa mbi aktet që duhet t'i kthehet palës), në zbatim të ligjit ne duhet të bëjmë propozim vetëm për sa i përket llojit dhe masës së tarifës. Jo për mënyrën pastaj se si kthehen pjesa e tarifave të paguara.

Këto ishin sugjerimet e mia në lidhje me aktin.

**Kelment Greca:** Në lidhje me përcaktimin që është në Kodin e Procedurës Civile në lidhje me gjobat, nuk kam gjetur që mund të ketë lidhje me njëra-tjetrën se këtu thuhet për tarifë, këtu është me gjobë. Prandaj edhe unë e kam ndarë këtë gjë dhe kam vënë sipas ligjit 98/2017 dhe nuk e kam marrë atë si përcakton Kodi i Procedurës Civile apo neni 34 që është gjoba. E kam parë si të ndarë. Edhe ligjvënësi kur e ka menduar këtë gjë e ka vendosur si të ndarë, si tarifë shtesë dhe jo si gjobë. Atë ia ka lënë gjykatës që të vendosë, kurse këtë gjë ia ka lënë që ta vendosë KLGj-ja si propozim për Ministrinë. Prandaj edhe s'e kam parë si gjobë, atë që thuhet si tarifë në ligj.

**Brikena Ukperaj:** Keli, kjo është tarifë shtesë sipas ligjit, kur pala shkakton shtyrje ose zvarritje të pajustificuara të gjykimit dhe në qoftë se kjo është tarifë, gjykata duhet ta zbatojë patjetër, nuk i lihet në vlerësim.

Nga ana tjetër, neni 34, parashikon që gjykata në çdo shkallë ku konstaton se ka sjellë qëllimisht zvarritjen e gjykimit, është e detyruar ta bëjë me gjobë, pra gjykata po e konstatoi do të aplikojë edhe tarifën edhe gjobën dhe unë në vlerësimin tim kam mbivendosje. Ndoshta duhet ta diskutojmë këtë pjesë.

**Fatmira Luli:** Ka një dallim midis të dyjave Brikena, ka një dallim. Ajo është për zvarritje abuzive dhe është sanksion, është gjobë. Është vënë termi "të paarsyeshme" dhe buron nga ligji për tarifat. Vetëm këtu mund të bëhet dallimi. Kur konstatohet që zvarritja është abuzive, gjyqtari vendos gjobë. Ndërsa kjo është një tarifë e përgjithshme që është përcaktuar për rastet e shtyrjeve të paarsyeshme, të vlerësuara nga gjykata. Ka përdorur terma të ndryshëm.

**Brikena Ukperaj:** Jo, nuk është term i ndryshëm Fatmira sepse neni 34 thotë: Gjkata në çdo shkallë të gjykimit, kur konstaton se palët ose përfaqësuesit me vetëdije paraqesin padi kërkesa, pretendime abuzive ose të përsëritura...

**Fatmira Luli:** “Abuzive” pra.

**Brikena Ukperaj:** ... ose kur kërkojnë qëllimisht të zvarrisin gjykimin. Pra është një shtyrje e pajustificuar e seancës gjyqësore.

**Fatmira Luli:** Jo! –është ndryshe kur thua është “abuzive” dhe ndryshe të thuash “e paarsyeshme”.

**Brikena Ukperaj:** Kërkesa mund të jetë abuzive.

**Fatmira Luli:** Abuzive është shkalla më e lartë, kur ai në mënyrë të hapur abuzon me kërkesën për shtyrje. Ka një rast me motive më të ulura që për gjykatën është e paarsyeshme. Kështu që kjo është diferenca. Terminologjia është përdorur në mënyrë të ndryshme.

**Ilir Toska:** Mund ta kem fjalën?

**Naureda Llagami:** Po zoti Toska!

**Ilir Toska:** Mendoj që tarifa është për të përballuar kostot e shërbimeve që ofrohen. Në këtë kuptim, nëse për shkak të sjelljes së palës krijohet një kosto në shërbimin që ofrohet, do duhet që pala ta përballojë. Nëse pala me veprimet e saj kryen veprime abuzive, kjo duhet të jetë indicie që gjykata të marrë sanksion ndaj palëve.

Për sa i përket kostove, pala sipas ligjit, do duhet të mbulojë koston.

Ky është edhe kuptimi i tarifës shtesë sipas meje.

**Brikena Ukperaj:** Pra Ilir, ti mendoj që nuk ka lidhje me gjobën?

**Ilir Toska:** Fakti që pala mund të ketë bërë kërkesa abuzive është një çështje që gjykata duhet ta vlerësojë për të administruar procesin, ndërsa fakti që pala ka sjellë kosto shtesë për procesin, do duhet që pala të mbulojë koston shtesë për procesin.

**Naureda Llagami:** Tjetër diskutim?

**Brikena Ukperaj:** Unë edhe një pyetje kisha.

Për kërkesat penale që vijnë në gjykatë, nuk shikoj të parashikuar asnjë... për shembull marr kërkesat me të dëmtuar akuzues që janë në një masë ndoshta edhe më të

madhe që disa herë bëhet edhe në mënyrë abuzive, nuk është parashikuar një tarifë e përgjithshme.

**Kelment Greca:** Të përgjigjem?

Tek neni 2 i ligjit thuhet: Qëllimi i tij është përcaktimi i tarifave gjyqësore në gjykimin e çështjeve civile administrative dhe në gjykimin në Gjykatën Kushtetuese. Nuk ka përcaktuar ligji për kërkesat penale. Prandaj nuk është marrë fare në shqyrtim kërkesat penale sepse është në qëllimin në nenin 2 të ligjit 98/2017.

**Ilir Toska:** Mund ta kem fjalën?

**Naureda Llagami:** Po, Ilir!

**Ilir Toska:** Në vijim të asaj që po diskutonim për tarifë shtesë, nuk e di, nuk jam i qartë se si është përcaktuar nga grupi i punës kjo tarifa shtesë (masa). Duket sikur masa e kësaj tarife shkon në masën që sanksionon gjykata. Pra në një farë mënyre, ajo shndërrohet në një lloj gjobe. Në vlerësimin tim, kjo tarifë shtesë, duhet të përballojë atë kosto shtesë që i shtohet shërbimit, pra do duhet të ketë një lloj vlerësimi se sa është kosto për seancat gjyqësore, që të përcaktohet një tarifë shtesë. Nuk mundet që kosto e tarifës shtesë të shndërrohet në një mjet ndëshkimi. Nuk është ky qëllimi i ligjit për tarifën shtesë. Qëllimi i ligjit, për ndëshkim është gjoba dhe e ka sanksionuar ligji sa është masa e gjobës. Ndërsa për tarifë shtesë do duhet të jetë pjesë e një procesi përllogaritjeje se sa shkon kosto shtesë e shërbimit dhe ajo do duhet të përballohet nga pala që shtyn në mënyrë të paarsyshme seancën. Pra kam përshtypjen që masa që është propozuar nga grupi i punës është shumë e madhe, ose do duhet të dalë si rezulton kosto shtesë.

**Kelment Greca:** Mundem të përgjigjem?

**Naureda Llagami:** Po, Keli!

**Kelment Greca:** Tek tarifa shtesë ne nuk kemi një kosto të proceseve gjyqësore. Edhe mbas diskutimeve që kemi bërë edhe me përfaqësuesit e Këshillit të Evropës për të na ndihmuar në lidhje me sa është kosto e një seance gjyqësore dhe si përcaktohet kjo

gjë, ata thanë që është e pamundur të nxirret. Edhe vendet e përparuara të Bashkimit Evropian nuk kanë një kosto të seancave gjyqësore. Në vende të ndryshme përcaktohet ndryshme. Seanca gjyqësore mund të jetë në një, dy, pesë, pesëmbëdhjetë seanca dhe nuk ka një llogari të saktë se sa shkon ajo. Prandaj është vendosur kështu, që të lihet në diskrecion të gjykatës që të vendosë mbi shkallën e neglizhencës dhe mbi shkallën e kostove që mund të zgjasë procesi pafundësisht. Prandaj është vendosur nga kaq në kaq. E vetmja gjë që mund të bëjmë.

**Ilir Toska:** Ai intervali është shumë i madh dhe shuma është shumë e madhe. Ne në princip mund të caktojmë sa është kosto, mbase jo për të gjitha por të gjejmë një mesatare, që të kuptojmë sa është një kosto shtesë.

**Brikena Ukperaj:** Keli të bëj një pyetje?

Tek pjesa e tarifës gjyqësore shtesë, përfshihet edhe shpenzimet që duhet të bëjë pala për përsëritjen e njoftimeve, për palët në proces?

**Kelment Greca:** Po pra është menduar e gjithë kjo. Sa herë që shtyhet seanca do kryhen njoftimet rishtazi për të gjitha palët dhe prandaj është vendosur kjo. Kjo është një shumë tek 10 000 – 20 000 lekë.

**Brikena Ukperaj:** Kjo tarifa, kjo që thua ti, përbën pagesë për shërbimin gjyqësor që kryen. Pra është më vete pagesa që bën pala për përsëritjen e njoftimeve nga tarifa gjyqësore shtesë. Tarfië gjyqësore shtesë se u shty seanca dhe të marrësh 200 000 lekë (të vjetra) është vlerë shumë e madhe për gjykimin në shkallë të parë, ndërkohë që në Gjykatë të Lartë shkon tarifë gjyqësore shtesë në maksimum 500 000 lekë, kur kaq është masa e gjobës.

**Kelment Greca:** Kjo është në kushtet e shtyrjes pa shkaqe të arsyeshme, nuk është në shtyrjen e një seance. Do ta vendosë gjykata pastaj a përbën neglizhencë apo është shtyrje me qëllim e seancave gjyqësore e me radhë. Është një gjë që është abstrakte që në koncept dhe do mbetet e tillë sepse nuk mund të bëjmë një përcaktim të saktë.

**Fatmira Luli:** Ne nuk kemi shumë mundësi të ndryshojmë tarifën shtesë, se tarifa shtesë është e përcaktuar në ligjin për tarifën dhe është në mënyrë taksative. Por ne mund të bëjmë një ndryshim tek tarifa për shtyrjen e seancave gjyqësore, që mos të ketë dublikim, mos të jenë për të njëjtën arsye, për të njëjtin veprim procedural të paguajë dy herë. Ndoshta, të hiqet si shtyrje tarifë për shtyrjen e seancës dhe të vendoset vetëm kjo që është tarifë shtesë. Ndoshta këtu mund të bëhet ndonjë korrektim i kësaj tabelës.

**Kelment Greca:** Më falni, por edhe këtë s'mund ta bëjmë se tarifa gjyqësore shtesë, mund të kemi shtyrje seancash për shkaqe të arsyeshme një-dy herë nga avokatët dhe paguan tarifën e shtyrjes së seancës por nuk jemi në kushtet e neglizhencës. Kështu që kjo është një tarifë që vihet kur është tejkaluar çdo gjë e arsyeshme për vazhdimin e seancave. Neve mund të kemi shkaqe të arsyeshme me kërkesë të avokatëve ose të palëve për shtyrje të seancave për shumë arsye të ligjshme dhe ai paguan vetëm tarifën e shtyrjes së seancës. Nuk jemi në rastet e aplikimit të tarifës shtesë. Tarifa shtesë është në shkallën e neglizhencës së palëve.

**Brikena Ukperaj:** Prandaj them unë merr natyrën e gjobës.

Domethënë pala penalizohet dy herë për të njëjtin veprim. Penalizohet sipas Kodit të Procedurës Civile me një shumë që shkon nga 50 000 lekë – 100 000 lekë, penalizohet edhe për herë të dytë me tarifë gjyqësore shtesë me një shumë që shkon nga 10 000 – 20 000.

**Fatmira Luli:** Po pra po, por e ka zgjidhur ligji atë. Nuk e ndryshojmë dot ne.

Ligji për tarifën i ka vënë vet tarifë shtesë, e ka konsideruar dhe e përcakton në mënyrë taksative kush është tarifa. Nuk kemi shumë mundësi ne të lëvizim në këtë pjesë.

**Brikena Ukperaj:** Ligji bën përkufizimin Fatmira, por ne kemi në dorë të përcaktojmë masën e tarifës. Masa e tarifës shkon në kufijtë e masës së gjobës.

**Fatmira Luli:** Gjoha është më e madhe. Është goxha më e madhe. Shkon 500 000 lekë.

**Ilir Toska:** Mund të them diçka?

Atëherë si e kuptoj unë?

Tarifa që paguhen fillimisht konsiderohen një proces ideal që zhvillohet në 2, 3, 4 seanca dhe ajo është kosto që ligjvënësi ka përcaktuar që duhet të paguhet për shërbimin. Kur kjo e kapërcen këtë gjë pra për shkak të shtyrjeve të paarsyeshme të seancave, duhet të përcaktohet tarifa shtesë. Tarifa shtesë nuk do duhet të jetë gjoba që parashikon ligji për sjellje abuzive.

**Kelment Greca:** Kjo është parashikuar. Kjo është logjika.

**Marçela Shehu:** Keli, edhe unë e kuptoj që tarifa shtesë është diçka tjetër nga gjoba. Problemi është se si do ta përllogarisim dhe cilët janë ata elementë konkretë që do të konsiderohen për përllogaritjen e tarifës shtesë sepse duke qenë kaq abstrakte siç thatë edhe ju, ajo përafrohet më shumë tek natyra e gjobës faktikisht, por nëse ne do të vendosim disa elementë konkretë se si do ta përllogarisim këtë tarifë, atëherë mund të bëjmë diferencimin nga gjoba. Unë nuk e di si e keni menduar ju, si do ta ndajë gjyqtari në praktikë.

**Kelment Greca:** Tek mënyra se si mbliidhen dhe paguhen tarifatat, unë kam vënë në shumë nga pikat këtu kam thënë sipas rregullave dhe udhëzimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ne mund ta nxjerrim një udhëzim si mund të bëhet kjo vjelja e kësaj tarife dhe kush mund të jetë shkalla e neglizhencës së gjykatës, por jo tek ky propozim, se ky propozim do jetë sipas një akti të miratuar nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave. Ne mund të nxjerrim rregulla më vonë, mbasi të miratohet kjo gjë se si do jetë vlerësimi nga gjykata i shkallës së neglizhencës së palës edhe për të aplikuar këtë tarifë shtesë. Mund ta shtojmë një pikë tek mënyra si mbliidhen dhe paguhen.

**Marçela Shehu:** Dakord. Domethënë ju propozoni që kjo të detajohet më vonë, në një akt më vete.



**Kelment Greca:** Nga diskutimet që dolën tani, them që të shtohet një pikë tjetër dhe të themi që në lidhje me tarifën gjyqësore shtesë të vendoset shkalla e neglizhencës dhe të vendoset me rregullim, me udhëzim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Edhe pasi të miratohet ky akt, mund të miratojmë një rregull që të përcaktojmë shkallën e neglizhencës dhe tarifë për secilën shtyrje seance, për shembull prej pesë seancash merr tarifë shtesë, prej 10 seancash... Nuk e di domethënë si mund të gjejmë një përcaktim të saktë.

**Brikena Ukperaj:** Sepse ligji të kërkon tek neni 7, pika 3, që tarifën gjyqësore ta kesh tarifë fikse. Thotë: Tarifa gjyqësore shtesë është tarifë fikse.

Nga ana tjetër, ti ke parashikuar një tarifë për shtyrjen e seancës. Pala që kërkon shtyrje të seancës do ta paguajë 15 mijë lekë të vjetra ose 1 500 lekë të vjetra si një tarifë gjyqësore të veçantë për veprimin procedural apo jo?

**Kelment Greca:** Po!

**Fatmira Luli:** E vlerësoj këtë pjesën e Brikenës.

Ajo ndoshta nuk duhet të jetë me alternativë nga 100 000 – 200 000 mijë por të jetë një shumë fikse që mos t'i lihet në dorë rast pas rasti gjykatës, meqenëse ligji referon tarifë fikse dhe nuk e lë me alternativë. Ndoshta kjo mund të korrigjohet. Mundet të shihet edhe mundësia që shtyrjet e seancave për shkaqe të justifikuara të mos jenë ndoshta në maksimumin e tarifës 2 500 lekë por të jenë pak më të ulëta, për të mos rënduar buxhetin e njerëzve që kanë shkaqe të arsyeshme për ta shtyrë seancën.

**Brikena Ukperaj:** Është 15 000 lekë të vjetra Fatmira çdo shtyrje seance (1 500 lekë të reja).

**Fatmira Luli:** 2 500 është.

**Brikena Ukperaj:** 1 500 e shoh unë këtu. Në shkallë të parë.

**Kelment Greca:** Në shkallë të parë është 1 500.

**Brikena Ukperaj:** Në shkallë apeli 2 500.

**Fatmira Luli:** Po!

Atëherë, mund të propozojmë që këtë 100 000 lekë deri në 200 000 ta bëjmë një tarifë 150 000 lekë për vonesat dhe tarifat e tjera ose t'i pakësojmë pak ose t'i lëmë ashtu siç janë.

**Marçela Shehu:** Nuk e di tani ngutshmërinë, por mos është më e nevojshme që duke u bazuar në këto diskutime të sotme, ta rikonsideroni edhe një herë aktin lidhur me këtë pjesë? Se puna është që ajo duhet menduar mirë. Pra s'është e thënë që duhet ta vendosim tani. Duke konsideruar të gjitha këto diskutime dhe mendime, ta rishikoni edhe një herë me qetësi para se ta kalojmë në Këshill.

**Fatmira Luli:** Mendoj që nuk ka shumë kundërshti. Këto janë dy gjëra të vogla që të caktojmë. Mos të bëhemi ne pengesë për këtë procedurë që ka nisur për tarifat, meqenëse ka shumë kohë që është nisur dhe duhet përfunduar.

**Kelment Greca:** Më fal, mund ta bëj një ndërhyrje?

Duke marrë shkas nga të gjitha diskutimet, mund të bëjmë një përcaktim që të kemi një tarifë fikse për të tre fashat e gjykatës (shkallë e parë, apel dhe Gjykatës së Lartë), por ajo që do ishte edhe duke parë edhe diskutimet që është tarifë goxha e lartë, të përcaktojmë një tarifë 10 000 lekë për në gjykatë të shkallës së parë, 20 000 lekë për në apel dhe 30 000 lekë për në Gjykatën e Lartë dhe të vëmë një pikë tek mënyra se si mblidhen dhe paguhen dhe të themi që KLGJ nxjerrë udhëzime mbi përcaktimin e shkallës së neglizhencës së palëve dhe vendosjen e tarifave shtesë.

**Ilir Toska:** Mund të them diçka?

**Naureda Llagami:** Po Ilir!

**Ilir Toska:** Atëherë, ne nuk mund të biem dakord tani të vëmë një tarifë dhe t'i ulim ato sepse ajo gjë duhet të jetë e justifikuar. Nëse ne nuk kemi një argument të caktuar, ne nuk mund t'i vëmë kështu këto tarifat. Prandaj nuk jam dakord që hajde të vendosim shpejt e shpejt tarifat dhe e mbyllim këtë histori. Mundet që për dy ditë të

arsyetojmë dhe të gjejmë një argument dhe të caktojmë një masë të caktuar e ta kalojmë në mbledhje. Por jo, hajde, se duhet ta kalojmë. Ato tarifatat janë shumë të larta.

**Brikena Ukperaj:** Veç kësaj, ajo që unë konstatoj është për shembull, duhet të kemi koherencë mbi trajtimin e kërkesave me natyrë të njëjtë procedurale, për shembull, nëse kërkohet një masë sigurimi padie para ngritjes së padisë dhe vlera është 1 500 lekë, pse kur kërkohet ndryshimi ose zëvendësimi i masës së sigurimit të padisë që është po një kërkesë e re, vlera është 1 000 lekë. Duhet të ketë koherencë mbi natyrën e çështjes; ose rivendosja në afat, në qoftë se do ta shikojmë si një kërkesë civile, pavarësisht se ka natyrë procedurale, duhet të ketë të njëjtën vlerë tarifa gjyqësore e përgjithshme siç kanë edhe kërkesat e tjera. Domethënë, duhet të ketë koherencë edhe midis natyrës dhe kërkesës civile.

Ndoshta do të ishte mirë që të uleshim dhe ta shikojmë edhe një herë për të arritur në një draft përfundimtar për vendimin. Jam dakord me propozimin që bën Marçela.

**Naureda Llagami:** Atëherë, jemi dakord që ta shtyjmë për ta riparë edhe një herë këto dy-tre çështje që diskutuam?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, kjo çështje e rendit të ditës do të shtyhet në një afat tjetër, pasi të sqarohen të gjithë diskutimet përkatëse.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 12.10.2020)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komision për Zhvillimin e Karrierës (relator z. I.Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zoti Alban Toro**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 4. Aleksandër Çavo, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.**
- 7. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe Projekti i USAID.**

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komision për Zhvillimin e Karrierës (relator z. I.Toska).

**Naureda Llagami:** Kalojmë në çështjen e fundit të rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Lidhur me relatimin e këtij projekt-akti fjalën ia jap zotit Ilir Toska.

**Ilir Toska:** Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Krahas vendimit ju është përcjellë edhe relacioni shpjegues lidhur me këtë projektvendim. Shkurtimisht mund t'ju them se pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 5 tetor 2020 është depozituar një kërkesë me shkrim protokolluar me aktin nr.4845 nga gjyqtari z.{...}, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëpërmjet të cilës ka parashtruar dorëheqjen nga statusi i magjistratit.

Z. {...}, është emëruar ndihmësgjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh, me Vendimin nr. 5, datë 01.07.1994, të ish- Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa me Vendimin nr. 5, datë 06.07.1995, të po këtij Këshilli, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh. Më pas është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për shkak të suprimimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh, me Vendimin nr. 235, datë 24.10.2008, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Me Vendimin nr. 256/3/b, datë 15.06.2010, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë e ka emëruar z.{...} në detyrën e inspektorit, ndërsa me Vendimin nr. 64, datë 27.05.2016, të po këtij Këshilli, ai ka marrë edhe një mandat të dytë si inspektor. Ndërkohë, me shkresën nr. 2732/14 prot., datë 16.05.2019, ai ka dhënë pëlqimin për të vazhduar ushtrimin e detyrës së Inspektorit/Nëpunësit përgjegjës në Njësinë Mbështetëse të ngritur pranë Komisionit përkatës për vlerësimin profesional pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 220, datë 22.10.2019, ka vendosur të deklarojë pasjen e statusit “Magjistrat” për z. {...}, si dhe të vijojë komandimin në detyrën e nëpunësit përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor deri në një vendimmarrje tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas nenit 65 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.

Si motiv të dorëheqjes z.{...} ka parashtruar “arritjen e moshës së pensionit”.

Pavarësisht dhënies së një motivi për dorëheqjen nga statusi i magjistratit, rezulton që z.{...} të mos ketë kërkuar që ajo të japë efekte para kohe, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 65 të Ligjit për Statusin. Për rrjedhojë, në rrethanat kur dorëheqja e z.{...} plotëson kërkesat e pikës 1, të nenit 65 të Ligjit për Statusin, është vendi që Këshilli i Lartë Gjyqësor të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z.{...}, disponim ky që, bazuar në pikën 2, të nenit 65, të Ligjit për Statusin, i jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli ka marrë deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Në këtë rast, kërkesa me shkrim e gjyqtarit z. {...} është protokolluar në Këshill më datë 05.10.2020 e për rrjedhojë, dorëheqja e tij i jep efektet në fund të muajit nëntor, konkretisht më datë 30.11.2020.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të dorëheqjes së tij.

2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 30.11.2020. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Erjon Muharremaj:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.



**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak të dorëheqjes së tij.

2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 30.11.2020.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po mbyllim edhe mbledhjen për sot.

**Ilir Toska:** Mund të them diçka Kryetare?

**Naureda Llagami:** Po!

**Ilir Toska:** Ju kam nisur një e-mail që sapo ka ardhur nga Gjykata e Apelit Korçë. Për shkak të shkarkimit nga detyra të zonjës {...} duhet të konsiderojmë caktimin e një gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë, pasi ditën e nesërme janë caktuar 12 masa sigurimi. Sapo t’i bëjmë gati materialet, do t’jua përcjell dhe të konsideroni që të bëjmë një mbledhje për këtë gjë.

**Naureda Llagami:** Dakord Ilir!

Nëse s’keni gjë tjetër, punë të mbarë!

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**